



Në 62-Vjetorin e BKUK-së përrurohet Qendra e Bibliotekës Universitare

Institucioni qendror i bibliotekarisë në Kosovë, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës, më 25 nëntor 2006, kremtoi 62-Vjetorin e themelimit dhe përruroi Qendrën e Bibliotekës Universitare - bërthamën e parë të formimit të Bibliotekës Qendrore të Universitetit të Prishtinës.

Në 62-Vjetorin, BKUK është në procesin e përmirësimit, të planifikimit dhe të organizimit të veprimtarisë në përputhje me nevojat dhe standardet bashkëkohore të bibliotekarisë. Teknologjitë e reja, karakteristike për shoqëritë e sotme, kanë krijuar nevojën për një reformimin teknologjik e administrativ të bibliotekave. Në këtë proces BKUK është në fazën e automatizimit të shërbimeve, si: katalogimit, pasurimit, huazimit, kërkimit automatik të të dhënave, krijimit të rrjetit të brendshëm, etj.

Ndërsa në procesin e realizimit të projekteve, themelimi i Qendrës së Bibliotekës Universitare është hapi i parë i krijimit të Bibliotekës

Qendrore të Universitetit të Prishtinës, i paraparë me Ligjin për biblioteka, dhe më tej i detajizuar në formë të projektit nga ish-drejtori i përkohshëm i BKUK-së dr. Keneth Oberembt. Ky projekt i përbashkët i BKUK-së, Ministrisë së Arsimit dhe i Zyrës së SHBA-ve në Prishtinë u mbështet edhe nga Instituti për Trajnim dhe Zhvillim (ITD) dhe Fakulteti i Bibliotekarisë dhe Shkencave të Informacionit (GSLIS) në Massachusetts, Këtë manifestim e nderuan me pjesëmarrje drejtues të institucioneve të Kosovës, përfaqësues të zyrave diplomatike në Kosovë, dekanë të Universitetit të Prishtinës, si dhe personalitete të kulturës, të artit e të shkencës.

Në fjalën e hapjes, drejtori i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, dr. Sali Bashota, shpalosi fakte për realizimin e projekteve në BKUK, si dhe për perspektivat e zhvillimit të këtij institucioni. Hapjen e Qendrës së Bibliotekës Universitare e përshëndeti, z. Larry Corwin, zyrtar për Marrë-

dhënie me Publikun i Zyrës Amerikane në Prishtinë, i cili ka qenë bartës dhe motivues i projektit për hapjen e kësaj qendre. Prof dr. Enver Hasani, rektor i Universitetit të Prishtinës, në fjalimin e tij përshëndetës e mirëpriti hapjen Qendrës së Bibliotekës Universitare, dhe premtoi për përkrahje dhe ndihmë konkrete për zhvillimin e mëtutjeshëm. Ndërsa, Besim Kokollari, shef i Qendrës së Bibliotekës Universitare, paraqiti mundësitë që ofron Qendra dhe perspektivën e zhvillimit të saj.

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës e nderoi me mirënjohje të veçantë Larry Corwin, Zyrtar për Marrëdhënie me Publikun në Zyrën Amerikane në Prishtinë, Me mirënjohje - për përkushtim dhe përgjegjësi në punë në BKUK, u shpërblye Hetem Ademi, zyrtarë për të hyra dhe pasuri Me rastin e 62-vjetorit të BKUK-së, u organizua edhe ekspozitë me tituj të rinj librit të koleksioneve lëndore.

Biblioteka e Krist Malokit në Prishtinë

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës gjatë këtij viti (2006), arriti të sigurojë një pjesë të bibliotekës personale të mendimtarit të njohur nga Prizreni, Profesor Dr. Krist Malokit, i cili u shkollua, punoi dhe krijoi në Graz të Austrisë. Në tetor të vitit 2006, drejtori i BKUK-së, Dr. Sali Bashota zhvilloi një takim në Maribor në familjen e argjendarit të njohur Mikel Kaçinari, me ç'rast bisedoi me zonjën Gonxhe Kaçinari lidhur me një pjesë të bibliotekës personale të intelektualit të njohur Dr. Krist Maloki, i cili i kishte lënë porosi gojore (amanet) zonjës së tij Freya Maloki, që ky fond i bibliotekës t'i dorëzohej BKUK-së në Prishtinë. Amaneti i Dr. Malokit u realizua në nëntor 2006, ku nga Maribori arritën dy kontingjente librash në BKUK.



Krist Maloki u lind në vitin 1900 në Prizren, kurse qysh në moshë të re shkoi në Austri, ku i kreu të gjitha shkollimet dhe studimet, deri në marrjen dy herë të gradës së doktoraturës, më 1929 mori doktoratën në Filozofi, kurse më 1934 doktoroi në Drejtësi. Punoi si mësues privat, studiues i pavarur, e më vonë profesor i Universitetit të Grazit. Vdiq në nëntor të viti 1972 në Graz.

Mendimtari, juristi dhe kritiku i letërsisë Dr. Krist Maloki, pati fatin të punojë dhe veprojë në Austri, po aty ku studiuari e vepruan shumë historianë e albanologë të njohur, si: Shuffaj, Tholloczy, Jeriçeku etj.

Prof. Maloki përveç se la pas vetes një numër të madh studimesh në gjuhën shqipe e gjermane të botuara e të pabotuara, ai la edhe një bibliotekë të pasur: 'atë bibliotekë që mbush katër mure të një dhome të madhe të katalogueme e të rregullueme siç dinte t'a rregullojë vetë Krist Maloki'.

BKUK arriti të sigurojë, sipas dëshmimeve, vetëm një pjesë të kësaj biblioteke të mbijetuar, që përmban tituj të rrallë e të veçantë. Shumë nga titujt po hyjnë për herë të parë në fondin e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës.

Në këtë bibliotekë, gjinden botime të ndryshme origjinale, të botuara nga Rilindësit tanë në Bukuresht, Sofje, Stamboll, Athinë etj., si: "Erveheja", Bukuresht 1888, "Dituritë për Mësoitoret e para", Bukuresht 1888, "Vakinat" prej Dom Paco Babbitt, Shkodër 1882 pastaj një pjesë e botimeve të para në gjuhën shqipe të botuara në Shqipëri e Kosovë.

Në këtë koleksion librash, gjejmë edhe disa tituj të periodikut të traditës, si: "Hylli i Dritës", "Leka", "Dituria", "Kumtari i Arsimuem", "Sherbestari i Shqiperise", "Fryma", "Përpjekja Shqiptare", pastaj fjalorët dhe grammatikat si: "Fialuer i Rii e Seypes", Itali 1908, "Fialuer i Voghel Scyp e Latinisc", Shkodër 1895, "Caratteri e Grammatica Della Lingua Albanese", Coriliano Calabro 1894, "Grammatik de Albanelichen Sprache", Wien 1908, "Lingua Albanese", Heidenberg 1915, etj.

GJON BERISHA

Në këtë numër



62-Vjetet të kuytesës së Kosovës.....3

Terminologjia e formatit MARC dhe
definicionet e tyre.....8

Koleksioni i Lëndëve Mësimore në
mbështetje të Universitetit të
Prishtinës.....10

Ndrikimi temperaturës, lagështisë dhe
ndriçimit në libër.....11

Kuytesa vegjetale dhe minerale:
e ardhmja e librit.....14

BIBLIOTEKA
KOMBËTARE
DHE UNIVERSITARE
E KOSOVËS



THE NATIONAL
AND UNIVERSITY
LIBRARY
OF KOSOVO

www.biblioteka-ks.org

Botues: BKUK • **Kryeredaktor i botimeve:** Dr. Sali Bashota

Kryeredaktor: Fazli Gajraku

Këshilli redaktues: Dr. Bahtie Gërbeshi-Zylfiu, Gjon Berisha, Besim Kokollari

Lektore: Hazbije Qeriqi • **Realizimi kompjuterik:** Hekuran Rexhepi

Fotoreporter: Bashkim Binaku

Adresa: Sheshi "Hasan Prishtina", p.n. Prishtinë

Tel: ++381 38 225-605, **Fax:** ++381 38 248-940 • **e-mail:** biblioteka@biblioteka-ks.org

62-Vjet të kujtesës së Kosovës

Kam kënaqësinë e veçantë që t'ju uroj mirëseardhjen më të dashur, me rastin e kremtimit të 62-vjetorit të themelimit të institucionit të parë të bibliotekarisë në Kosovë - Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës.

Kësaj ceremonie solemne sot po i bashkohet edhe realizimi i njërit prej projekteve më kapitale në fushën e kulturës, arsimit, shkencës - themelimi i Qendrës së Bibliotekës Universitare, projekt i përbashkët i BKUK-së dhe i Zyrës së SHBA-ve në Prishtinë.

Ky projekt është propozuar dhe përkrahur nga Zyra e SHBA-ve në Prishtinë dhe nga Zyra për Çështje të Arsimit dhe të Kulturës në Departamentin e Shtetit Amerikan, si dhe është financuar nga Qeveria Amerikane. Realizues të projektit për trajnimin specializues të nëntë bibliotekarëve (gusht-dhjetor 2005) kanë qenë Instituti për Trajnim dhe Zhvillim (ITD) dhe Fakulteti i Bibliotekarisë dhe i Shkencave të Informacionit (GSLIS) në Massachusetts.

Shuma e këtij shkollimi dhe trajnimi është 350 mijë dollarë amerikan.

Në kuadër të zhvillimit të këtij projekti Zyra Amerikane në Prishtinë, ia ka ndarë, në këtë vit, BKUK-së grantin me vlerë 70 mijë dollarë amerikan që përmes Konsorciumit të Bibliotekave Elektronike, të bëhet abonimi në revistat më të njohura elektronike të botës në tri vjetët e ardhshme, si dhe për literaturë universitare.

Themelimi i Qendrës së Bibliotekës Universitare, është hapi i parë i konk-



retizimit të projektit për themelimin e një institucioni të ri, që do të jetë Biblioteka Qendrore Universitare, siç parashihet edhe sipas ligjit të miratuar në Kuvendin e Kosovës në vitin 2003. Prandaj, si të veçanta - Biblioteka Kombëtare e Kosovës dhe Biblioteka Qendrore Universitare, do të luanin misionin e tyre të përgjithshëm nacional edhe për zhvillimin e të gjitha llojeve të bibliotekave në Kosovë.

Në këtë drejtim, kontributi i Qeverisë së Kosovës, Ministrisë së Arsimit, Ministrisë së Kulturës, Universitetit të Prishtinës, BKUK-së, Zyrës Amerikane në Prishtinë dhe i partnerëve të tjerë, është i mirëseardhur, madje i domosdoshëm në realizimin sa më të shpejtë të projektit.

BKUK tashmë e ka përcaktuar qartë rolin dhe misionin e saj në procesin e zhvillimit të bibliotekarisë shqiptare në shekullin 21, edhe me manifestimin ndërkombëtar *Java e Bibliotekës në Kosovë*, i cili që nga viti 2003 është themeluar si institucion i përbashkët i BKUK-së dhe i Zyrës së SHBA-ve në

Prishtinë, ku marrin pjesë me kontributet e tyre ekspertë të njohur të bibliotekave amerikane dhe evropiane.

Po kështu, viti 2006 do të çelë një kapitull të veçantë në historinë e bibliotekarisë shqiptare, me themelimin e institucionit të ri kulturor-shkencor të përbashkët Shqipëri-Kosovë, siç është *Konferenca Kombëtare e Bibliotekonomisë*, e cila sivjet i zhvilloi punimet e edicionit të parë më 20 dhe 21 nëntor 2006 në Tiranë, me temën bosht: *Bibliotekat në botën e re demokratike*, ku, ndër të tjera, u diskutua për

funksionimin e sistemit të bibliotekave në Kosovë dhe në Shqipëri, për zhvillimin e mendimit kombëtar në fushën e shkencës së bibliotekarisë, për sfidat globale në fushën e teknologjisë dhe të komunikimit etj., për të krijuar më në fund në mënyrë institucionale projektin e strategjisë nacionale për bibliotekat shqiptare. Gjithsesi, edicioni i dytë, i cili do të mbahet në Prishtinë do të sjellë rezultate të dëshiruara.

Që nga viti 2003, BKUK ka realizuar një varg projektsh kapitale me interes nacional e më gjerë, që e përcaktojnë të tashmen dhe të ardhmen e këtij institucioni, qoftë në fushën e riparimit dhe të krijimit të infrastrukturës së re, qoftë në fushën e profesionalizmit të kuadrit. Prandaj, tashmë në hapësirat e BKUK-së, pos departamenteve të saj, funksionojnë edhe: Qendra Amerikane, Qendra Informative e BKUK-së për Qeverisje Parlamentare, Biblioteka e NATO-s, Biblioteka e Artit Bashkëkohor, Arkivi Medial, Arkivi i Shkrimtarëve, Sistemi i automatizuar bib-

liotekar Aleph 500, (deri më tani janë kataloguar mbi 30.000 ekzemplarë), Kodi i sigurisë së librit (Biblioteka RFID), transporteri i ri i librit, Qendrën për këshillime dhe karrierë të studentëve etj. Së shpejti, do të kemi edhe këndin e bibliotekës së mendimtarit të njohur Krist Maloki, i cili e ka lënë porosinë gojore para sa vitesh, që fondi i bibliotekës së tij personale t'i dhurohet BKUK-së.

Sic është e ditur, BKUK ka kryer revizionin e koleksioneve bibliotekare dhe depot e librit janë rregulluar sipas standardeve bashkëkohore.

Tashmë BKUK i ka pasuruar fondet e saj me libra të rinj, por dhe të rrallë. Po kështu, institucioni ynë brenda këtyre dy viteve ka dhuruar për bibliotekat e Kosovës dhe jashtë saj mbi 25 mijë ekzemplarë librash nga fondi i saj rezervë. Tashmë BKUK e ka revistën e vet *Biblioletra* dhe shumë botime të tjera profesionale nga fusha e bibliotekarisë nga autorë shqiptarë, shumica punonjës të Bibliotekës dhe nga autorë botërorë.

BKUK është anëtare e Lidhjes së Bibliotekave Hulumtuese të Evropës (LIBER), pjesëmarrëse në Konferencën e Bibliotekave Botërore IFLA (Federata Ndërkombëtare e Asociacioneve Bibliotekare),

Tashmë, BKUK ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe bashkëpunon me bibliotekat amerikane, Bibliotekën e Kongresit Amerikan, bibliotekat nacionale e universitare të Shqipërisë, Gjermanisë, Polonisë, Rumanisë, Zvicrës, Francës, Sllovenisë etj., dhe ky bashkëpunim pritet që të rritet në të ardhmen.

Gjithashtu, BKUK, përmes Agjencisë Kombëtare të ISBN-së në Kosovë, përfaqësohet në konferenca ndërkombëtare kudo në botë.

Gjithsesi, duhet thënë se BKUK ka fituar donacione të mëdha, qoftë të librave qoftë të inventarit.

Në maj të këtij viti, BKUK së bashku



me Zyrën e SHBA-ve në Prishtinë, e cila ka ndarë 20 mijë dollarë për pajisje teknike dhe literaturë, së bashku kanë kontribuar për themelimin dhe hapjen e Bibliotekës komunale në Skenderaj.

Të gjitha këto projekte të përmendura, dhe shumë të tjera, nuk do të ishin realizuar pa vullnetin, përkushtimin dhe sakrificën e punonjësve të këtij institucioni. BKUK ka edhe shumë projekte të tjera më rëndësi të veçantë për librin, bibliotekën, kulturën, historinë, të tashmen dhe të ardhmen e Kosovës.

Pos projektit esencial të krijimit të rrjetit unik të sistemit të automatizuar bibliotekar në Kosovë, edhe në bibliotekat ndërkombëtare, komunale etj., projekti më i madh që synon BKUK në të ardhmen është projekti i emërtuar *Kujtesa e Kosovës*, i hartuar sipas modelit të projektit *American Memory* në Bibliotekën e Kongresit.

Tani BKUK e ka përmbyllur me sukses periudhën e reformave, duke filluar nga Bordi Ekzekutiv i MASHT-it në fund të vitit 2002, dhe duke iu falënderuar punës së pakursyer të ish-drejtorit të përkohshëm nga SHBA-të dr. Keneth Oberembt. Në këtë periudhë kanë filluar fuqishëm të projektohen

idetë funksionale në procesin e avancimit të dijeve, koncepteve, rezultateve në fushën e bibliotekarisë, sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare. Tashti kontributi i shtuar i Zyrës Amerikane në Prishtinë dhe i z. Lary Corwin po rezultojnë me sukses të plotë.

Tashti dhe në të ardhmen, BKUK do të mbrojë dhe të nxisë lirinë intelektuale, do ta pasurojë dhe ta ruajë trashëgiminë kulturore kombëtare, do të mbështesë fuqizimin dhe mbrojtjen e ligjeve në fuqi të përdorshëm për secilin punëtor të saj.

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës e ka krijuar vizionin e vet të qartë dhe të sigurt për të ardhmen e saj. E ardhmja e saj do të ndriçojë nga ky Tempull i Dijes, edhe për të ardhmen e bibliotekave të tjera të Kosovës.

Urime dhe Gëzuar *Dita e Bibliotekës!*
Urime dhe Gëzuar Hapja solemne e *Qendrës së Bibliotekës Universitare!*
Prishtinë, 25 nëntor 2006

(Fjalë e drejtorit të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës - prof. dr. Sali Bashota, në 62-Vjetorin e BKUK-së e të përvjetorit të Qendrës së Bibliotekës Universitare)

Zyra Amerikane në Prishtinë në mbështetje të Bibliotekës Universitare

Kjo është një ditë e mrekullueshme, një ngjarje ngazëlluese e cila shënon diçka për të cilën kanë punuar me përkushtim shumë njerëz që një kohë të gjatë që kjo të bëhet realitet. Kjo filloi disa vite më parë si vizion i drejtorit të përkohshëm dr. Kenneth Oberembt, dhe që prej atëherë kjo ide i ka përfshirë si kosovarët ashtu edhe amerikanët.

Njerëzit janë marrë dhe vazhdojnë të merren me ofrimin e ndihmës për jetësimin e këtij plani të Bibliotekës Universitare. Terry Plum, bibliotekar nga Amerika, i cili e ka ushqyer këtë ide, ju dërgon të fala këtë mëngjes duke thënë se kishte pasur dëshirë të ishte sot këtu, kështu që më kërkoi t'jua përcjellë admirimin dhe respektin e tij për punën që kanë bërë bibliotekarët kosovarë për krijimin e Bibliotekës Universitare.

Dr. Plum kishte menduar se roli i tij ishte të koordinonte aftësimin e bibliotekarëve universitarë në SHBA. Nuk e kishte pritur që do të kthehej dy herë në Kosovë, si dhe të planifikonte që të vijë përsëri në janar. Edhe njëherë ai do të sjellë me vete disa ekspertë të bibliotekave nga SHBA, të cilët po ashtu mendonin se roli i tyre do të ishte vetëm bartja e ekspertizës së tyre të bibliotekarët nëpër klasa dhe biblioteka në SHBA.

Tani edhe ata janë përfshirë në këtë projekt të rëndësishëm, duke siguruar që studentët e Universitetit të Prishtinës të kenë një objekt që u ndihmon atyre në arsimim, që u jep atyre qasje në dijen e botës, që u hapë rrugën drejt ideve dhe teknologjisë më të fundit, dhe që do t'u ndihmojë atyre dhe Universitetit të bëhen pjesë e mirëfilltë e shekullit XXI. Shkrimtari dhe redaktori amerikan, Norman Cousins, shkruante (në buletin e Shoqatës së Bibliotekave të Amerikës, 1954), "Biblioteka nuk është altar dhe vend për adhurimin e librit. Nuk është tempull ku temjani letrar duhet të digjet apo ku edhe përkushtimi i ndokujt për librat voluminoz duhet të shprehet në rite. Biblioteka, për ta parafrazuar metaforën e famshme të Sokratit, duhet të jetë dhoma nga ku

lindin ide – një vend ku historia jetësohet".

Si do të ishte e mundur që ekspertët tanë amerikanë të mos bëheshin pjesë e diçkaje kaq ngazëlluese dhe të rëndësishme.

Ne kemi arritur mjaft, kështu që na duhet dita e sotme ta shënojmë këtë arritje, si dhe ta shfrytëzojmë rastin që t'u shprehim mirënjohje njerëzve, që kanë punuar kaq shumë për të ardhur deri këtu, pra dr. Sali Bashotën, disa pjesëtarë të personelit tim, të cilët kanë filluar të punojnë në këtë projekt, madje para se të vija këtu në Kosovë, dhe sidomos bibliotekarët, të cilët janë përpjekur që ta vënë në jetë këtë projekt edhe pse janë ballafaquar shumë herë me mungesë të resurseve apo edhe mungesë të të kuptuarit se çfarë po bënin. Njëra prej kënaqësive të vërteta të punës sime në këtë projekt ka qenë njohja me personelin, dhe mendoj që Universiteti ka shumë fat që ka një personel të tillë.

Mirëpo, na mbetet edhe shumë për t'u bërë para se kjo bibliotekë e re ta përmbush vizionin e Ken Oberembt-it, si dhe të ofrojë shërbimet, të cilat me të vërtetë i meritojnë studentët. Tani që Biblioteka dhe personeli i saj kanë dëshmuar me njohuritë e tyre se si të krijohet një institucion i rëndësishëm është koha për të gjithë ne që ta përkushtojmë vetveten për të kryer pjesën që na takon për studentët e Kosovës.

Presidenti amerikan John F. Kennedy tha: "Ne nuk ia kemi frikën plasimit të ideve të huaja te populli amerikan, fakteve që nuk na pëlqejnë, filozofive të huaja dhe vlerave konkurrenente. Për një komb, i cili ka frikë që ta lejojë popullin e tij ta gjykojë të vërtetën dhe të rremen në tregun e hapur, është një komb i cili ka frikë nga vetë populli i tij."

Për llojin e shoqërisë për të cilën dëshirojmë të jetë Kosova, ne duhet të vazhdojmë ta vemi në jetë vizionin e Ken Oberembt-it.

Është koha që ta identifikojmë dhe ta kërkojmë një ndërtesë me hapësirë të mjaftueshme për librat dhe pajisjet si



dhe për studentët që të punojnë. Është koha të punësojmë dhe të aftësojmë personelin që biblioteka të funksionojë me orar të plotë në mënyrë që të gjithë studentët të mund t'i shfrytëzojnë shërbimet e saj.

Është koha për fakultetet e Universitetit, të cilat nuk janë pjesë e kësaj biblioteke – të cilat po i ruajnë raftet e tyre të librave, ose kanë frikë të hyjnë në botën moderne – të krijojnë ura lidhëse për koleksionet e tyre me Bibliotekën Universitare dhe t'ua hapin rrugën lëndëve dhe studentëve të tyre drejt këtyre burimeve të reja të informacionit.

Nuk kam fjalë për këtë. Ne dëshirojmë që Universiteti t'i arrijë standardet ndërkombëtare, t'i edukojë studentët tuaj që të bëhen pjesë e Evropës moderne dhe të ekonomisë globale. Presim nga Universiteti që të japë kontribut në krijimin e një Kosovë moderne dhe të begatë. Ne duhet t'i japim kësaj biblioteke madhështore objektin, personel të mjaftueshëm dhe mbi të gjitha respektin, që e meritojnë studentët.

Prishtinë, 25 nëntor 2006

(Fjalë përshëndetjeje e z. Lawrence Corwin, Zyrtar për Marrëdhënie me Publikun

në Zyrën Amerikane në Prishtinë, në 62-Vjetorin e BKUK-së e të përirimit të Qendrës së Bibliotekës Universitare)

Biblioteka Universitare për moralin akademik e shkencor

Më vjen shumë mirë që sot jemi bashkë. Në fakt, ndihem i lumtur që jam në mesin tuaj dhe atë për shumë arsye. Para se t'i them arsyet në fjalë, me lejoni të falënderoj drejtorin e Bibliotekës, prof. Sali Bashotën, z. Lary Corwin, përfaqësuesin e Zyrës Amerikane në Kosovë, që kanë dhënë kaq shumë për ndërtimin dhe rimëkëmbjen e kulturës së leximit publik në Kosovë, të këtij segmenti kaq të neglizhuar në jetën tonë këtyre dekadave të sundimit serb dhe pas tij, pasi u bë çlirimi ynë nga ky sundim krejt përbindësh. Një pjesë bukur e madhe e mungesës së kësaj kulture të leximit publik i dedikohet kohës kur luftuam për të mbijetuar si qenie biologjike, por jo pak kohë ka të bëjë edhe me anarkinë dhe kaosin që u la pas luftës së Kosovës në qershorin e vitit 1999. Pas kësaj u bë një gjendje ku vërtet të vinte turp për disa vite të kaloje kah Biblioteka, kah objekti që kishte në vete pjesëza të jetës dhe karakterit tonë individual e kolektiv. Nuk i gjasonte një objekti kulturor përveç po të shikohej nga distanca. Restaurimi i dinjitetit të këtij objekti tonë të shenjet sigurisht se lidhet me meritën e drejtorit të sotëm, prof. Sali Bashotës, i cili me përkushtim të paepur ia riktheu shkëlqimin dhe tërheqjen estetike Bibliotekës sonë të dashur.

Më lejoni tani t'u kthehem arsyeve të sipërcekura. Në rend të parë, më duhet të them se jam i vetmi rektor në rajon që drejton një institucion të arsimit të lartë që nuk ka bibliotekë. Ato që këtu quhen biblioteka, nuk janë veçse leximore të thjeshta, ku zakonisht kanë dy persona të moshuar që japin dhe marrin librat



studentëve në intervale të ndryshme kohore, pra që në asnjë rast nuk kalojnë kohën e pasperëndimit të diellit. Kjo gjendje, si është sot, vërtet është e papranueshme për Kosovën, që u fut në shekullin XXI dhe për Kosovën shtatë vjet pas luftës. Duhet të bëjmë çdo gjë për ta ndërruar këtë gjendje.

Kur filluam bisedat me prof. Bashotën lidhur me themelimin e Qendrës së Bibliotekës Universitare, për mua ka qenë një gëzim i madh dhe pas asnjë rezervë ose hezitim kam pranuar ofertën e drejtorit Bashota për të qenë pjesë e këtij projekti. Kam kërkuar nga Këshilli Drejtues i UP-së ndarjen e 60 mijë eurove si fillim për ndërtimin e kapaciteteve të para të kësaj qendre në hapësirën e Fakultetit Filologjik, në mënyrë që gradualisht ta koncentrojmë tërë këtë kapacitet në një objekt të vetëm, por edhe në ndërkohë t'i bëjmë lidhjet e sistemeve të bibliotekave të fakulteteve të UP-së në një sistem të vetëm. Kjo nuk bëhet shpejt dhe do përkushtim e mund të madh. Kërkon trajnim të stafit ekzistues të bibliotekave tona nëpër fakultete, të atyre leximoreve, të cilat

të vjen keq t'i krahasosh me simotrat e tyre jashtë vendit. Më kujtohet koha kur kam ardhur asistent këtu në Fakultetin e Drejtësisë, më 1987. Në atë kohë në bibliotekën e këtij fakulteti vinin pa ndërprerë shtatë revista në gjuhën angleze, më profesionale dhe më prestigjiozet në botën akademike të drejtësisë, një në gjermanisht, një në italisht, një në frëngjisht dhe një në gjuhën ruse, pa llogaritur këtu të gjitha revistat profesionale të popujve të ish-Jugosllavisë. Fondi i librave ka qenë i pabesueshëm për kohën e sotme, aktiv dhe i skeduar për mrekulli. Kjo sot nuk ekziston në këtë fakultet, dhe në asnjërin prej njësive akademike të universitetit tonë të vetëm publik.

Nuk mund të ketë zhvillim shkencor e kulturor pa bibliotekë, kurse ngritja shkencore e avancimi akademik, në një vend pa bibliotekë serioze të specializuar universitare nuk është veçse një absurd i llojit të vet, një paradoks që cenon rënd moralin akademik e shkencor të të gjithë neve. Ndalimi i kësaj gjendje ka qenë dhe është forca shtytëse që më rri prapa mua dhe bashkëpunëtorëve të mi në angazhimin tonë të pazezervë e me përkushtim ndaj projektit të sapofilluar për Qendrën e Bibliotekës Universitare. Në vijim të arritjes së këtij qëllimi dhe për hir të realizimit të kësaj ideje fisnike, më lejoni t'ju uroj punë të mbarë e sukses të madh. Ju siguroj për mbështetje të vazhdueshme në këtë drejtim.

Prishtinë, 25 nëntor 2006

(Fjalë e z. Prof. Enver HASANI, PhD, rektor i UP-së, në 62-Vjetorin e BKUK-së e të përvjetimit të Qendrës së Bibliotekës Universitare)

Kapitull i ri në sistemin bibliotekar të Universitetit të Prishtinës

Kam kënaqësinë të them pak fjalë për Qendrën e Bibliotekës Universitare, e cila po hapet sot zyrtarisht me rastin e kremtimit të Ditës së Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare. Hapja e Qendrës së Bibliotekës Universitare shënon hapin e parë drejt realizimit konkret të ndarjes së Bibliotekës Universitare nga ajo Kombëtare ashtu si është paraparë me Ligjin për biblioteka të miratuar nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2003. Po ashtu hapja e kësaj Qendre shënon edhe hapin e parë konkret drejt afrimit të mirëfilltë të kësaj biblioteke me Universitetin e Prishtinës, misioni i së cilës është mbështetja e procesit arsimor e hulumtues që zhvillohet në këtë universitet. Për të mbështetur këtë mision Qendra e Bibliotekës Universitare ka filluar me katër shërbime bazë: Shërbimin e Referencave, Shërbimin e Qarkullimit (të Huazimit), Shërbimin e Koleksioneve Lëndore, dhe Shërbimin e Kompjuterëve, një ndër shërbimet më të popullarizuara. Këto shërbime jo vetëm që synojmë t'i zgjerojmë, por edhe të shtojmë shërbime të tjera. Hapjes së Qendrës së Bibliotekës Universitare i parapriu një investim shembullor në zhvillimin e personelit dhe blerjes së koleksioneve nga dy institucione partnere të kësaj Qendre, Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës dhe Zyrës Amerikane në Prishtinë. Qendra e Bibliotekës Universitare ka vënë në dispozicion të studentëve e përdoruesve të tjerë materiale



referale, kompjuterë për shfrytëzim, si dhe ka blerë një mori bazash të revistave elektronike nëpërmjet ndihmës së Zyrës Amerikane në Prishtinë, dhe nëpërmjet Konsorciumit të Bibliotekave Elektronike që vepron në kuadër të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare. Kështu, kjo qendër tashmë ka një abonim në mase 23,761 titujsh revistash elektronike nëpërmjet internetit dhe një koleksion bazë të librave në raftet e saj. Një bashkëpunim i personelit të kësaj Qendre dhe një pjese të personelit të Universitetit të Prishtinës për përzgjedhjen e materialeve të detyrueshme për studentë ka sjellë si rezultat blerjen e qindra titujve universitarë në bibliotekë. Personeli i bibliotekës nuk do të ndalet duke u ofruar bashkëpunim rektoratit dhe personelit të Universitetit të Prishtinës për përzgjedhje e literaturës së duhur për mbarëvajtjen e procesit mësimor në Universitet. Megjithatë, gjej rastin të bëjë thirrje

që këtij bashkëpunimi t'i përgjigjen me seriozitet rektorati dhe të gjitha fakultetet duke e konsideruar Qendrën e Bibliotekës Universitare dhe personelin e saj pjesë integrale të proceseve arsimore e hulumtuese të Universitetit të Prishtinës.

Duke i shprehur falënderim të veçantë Zyrës Amerikane në Prishtinë, dhe mbështetjen e plotë nga Zyrtaari për Marrëdhënie me Publikun, z. Larry Corwin dhe personelit të tij në këtë zyrë për kontributin e madh që ka dhënë dhe po jep për zhvillimin e kësaj qendre, duke uruar që bashkëpunimi me Universitetin e Prishtinës do të jetë i nivelit shërbime –investime – zhvillime, duke falënderuar gjithë personelin e bibliotekës për punën plot sfida dhe kontributin e madh në shtyrjen përpara të proceseve nga dr. Bashota, duke shpresuar që do të gjejme mirëkuptim në Ministrinë e Arsimit për shtimin e personelit në bibliotekën tonë për t'i përballuar punët që na dalin përpara, si dhe duke shpresuar në realizimin e ndërtimit të një objekti të ri për Qendrën e Bibliotekës Universitare, që eventualisht do të shndërrohet në Bibliotekë Qendrore të Universitetit të Prishtinës, i urojmë punë të mbarë Qendrës së Bibliotekës Universitare në përmbushjen e misionit të saj.
Prishtinë, 25 nëntor 2006

(Fjalë e Besim Kokollarit, shef i Qendrës së Bibliotekës Universitare, në 62-Vjetorin e BKUK-së e të përrurimit të Qendrës së Bibliotekës Universitare)

Terminologjia e formatit MARC dhe definicionet e tyre

(vijon nga numri i kaluar)

“Kontrolli i autorizuar” nënkupton respektimin e një forme të njohur a të themeluar. Zakonisht, një katalogues e zgjedh një përcaktuese lëndore ose të emrit nga një listë e miratuar e përcaktueseve. Për shembull, gjatë një bisede, nëse ju flisni për një vizitë në “Getty Museum” dhe “J. Paul Getty Museum” në Kaliforni, ai që ju dëgjon do të kuptojë se ju flisni për gjënë e njëjtë. Mirëpo, nëse një katalogues njëherë përdor “Getty Museum” dhe herën tjetër “J. Paul Getty Museum” si përcaktuese në katalog, atëherë përdoruesi i bibliotekës do ta ketë të vështirë t’i gjejë të gjitha librat në atë lëmi. Nëse kataloguesi e respekton listën e Bibliotekës së Kongresit për formën e autorizuar të emrave, ai apo ajo do ta përdor përcaktuesen “J. Paul Getty Museum”. Nëse e respekton gjithnjë këtë rregull, atëherë të gjitha librat për atë muze do të gjenden në një vend në katalog.

Lista më e mirë për emra është Lista e emrave të autorizuar të Bibliotekës së Kongresit. Kjo listë ekziston në forma të kuptueshme për kompjuterin të vënë në dispozicion nga Shërbimi për shpërndarjen e njësive kataloguese të bibliotekës së Kongresit ose në Internet në: <http://authorities.loc.gov>. Forma e autorizuar e emrave në përdorim

(emra personal, emra të korporatave, emra të konferencave ose takimeve, tituj të serisë/koleksionit, dhe tituj uniform) mund të krahasohet me këtë listë të autorizuar.

Ndërsa, për emrat lëndorë a

autorizuara të Bibliotekës së Kongresit. Kështu që, pesë vëllime të mëdha e përfshijnë *Listën e përcaktueseve lëndore të Bibliotekës së Kongresit*. Shkollat dhe bibliotekat speciale zakonisht përdorin vetëm një pjesë të tyre.

Ajo që është me rëndësi ka të bëjë me “kontrollin e brendshëm të autorizuar” të bibliotekave me katalogë të kompjuterizuar. Ky lloj kontrolli u ndihmon bibliotekarëve të kërkojnë listën e përcaktuesve lëndorë ose të emrave të autorizuar në sistem dhe të përdorin atë që gjendet aty. Në këtë mënyrë, të gjitha përcaktueset për emrin e njëjtë të një personi a lënde do të përdoren në mënyrë krejtësisht të njëjtë – që është edhe krejt rëndësia e njësive të autorizuar. Emrat që i gjejmë në Katalogimin në botim (CIP), në libra po ashtu, bazohen në njësitë e autorizuar të Bibliotekës së Kongresit në kohën kur ato botohen. Po ashtu, edhe format e shfaqura për materialet e botuara në katalogët në



geografikë, listat më të zakonshme të autorizuar janë *Lista e përcaktueseve lëndore të Bibliotekës së Kongresit* dhe *Lista e përcaktueseve lëndore Sears*. Forma e një përcaktuese lëndore duhet të jetë në përputhje me njërin prej këtyre listave ose të respektohen rregullat për krijimin e një përcaktuese të re.

Në një kompjuter personal është e vështirë që të ruhen të gjitha listat e

Internet, pas konvertimit retrospektiv, duhet të jenë të sakta pasi gati të gjitha bazat e të dhënave të shitësve të ndryshëm bazohen në listat e formatit MARC të Bibliotekës së Kongresit.

Shprehja “konvertim retrospektiv” paraqet projektin për konvertimin e njësive bibliografike nga forma e tyre fillestare – si e skedave ose njësive të krijuara shkurt në qarkullim –

në njësi të plotë bibliografike të kuptueshme nga kompjuteri. Shprehja retrospektiv përdoret për arsye se projekti bëhet për koleksionet ekzistuese të një biblioteke – të gjitha materialet që gjenden në bibliotekë deri në kohën kur fillon konvertimi. Konvertimi retrospektiv zakonisht bëhet duke i krahasuar njësitë e vjetra bibliografike të bibliotekës (pa marrë parasysh a janë në skeda letre apo ndonjë format që nuk bazohet në formatin MARC) me një bazë të dhënash me njësi të plota bibliografike. Bibliotekari mund të blejë njësi ekuivalente në formatin MARC sesa të futë në kompjuter në mënyrë mekanike të gjitha informacionet për të krijuar një njësi të re bibliografike.

Përmbajtja paralele. Fushat që kërkojnë kontrollin e autorizuar janë fusha të cilat po ashtu përdorin një ndërtim paralel të tageve. Në përgjithësi, në fushat 1XX, 4XX, 6XX, 7XX dhe 8XX, një emër personal do të ketë dy shifrat e fundit 00. Prandaj, për një përcaktuese kryesore (1XX), që është emër personal (X00), tagu i saktë do të jetë 100. Për një përcaktuese lëndore (6XX) që është emër personal, tagu i saktë është 600, e kështu më radhë. Kjo përmbajtje paralele mund të përmbledhet si vijon:

X00	Emrat personalë
X10	Emrat e korporatave
X11	Emrat e takimeve
X30	Titujt uniformë
X40	Titujt bibliografikë
X50	Terma (përcaktuese) lëndore
X51	Emra gjeografikë

Nëse e kombinojmë këtë paraqitje të fushave me fushat më lartë të ndara në qindëshe, bëhet e qartë se nëse një libër ka për tematikë lëndore (6XX) një person (Lincoln,

Abraham), tagu do të jetë 600; nëse tematika lëndore e një libri është korporatë (Apple Computer, Inc.), tagu do të jetë 610; nëse tematika lëndore e një libri është (hekurudhat), atëherë tagu do të jetë 650; nëse tematika lëndore e një libri është një vend (Shtetet e Bashkuara), tagu është 651. Një përcaktuese shtesë (7XX) për bashkautor (emër personal) do të marrë tagun 700.

Sistemi i klasifikimit sipas Dewey-it përdor një ndërtim të ngjashëm të tabelave për vendet gjeografike dhe për nënndarjet standarde të këtij sistemi.

6. Informacionet unike paraqiten në fillim të njësisë të formatit MARC

Njësia në formatin MARC në pjesën që i paraprin përmbajtjes kryesore të njësisë bibliografike – e cila është e njohur për bibliotekarët, për shkak të pranisë së tyre në katalogët prej skedave në letër – përmban informacione më pak të njohura. Katalogët e automatizuar zakonisht i krijojnë të dhënat në mënyrë automatike, në mënyrë që bibliotekari të mund t'i fusë informacionet e duhura.

Numri udhëheqës. Numri udhëheqës paraqet 24 karakteret e para, që shfaqen në një njësi. Secila pozitë e ka kuptimin e vet të caktuar, mirëpo pjesa më e madhe e informacionit i hyn në punë kompjuterit. Programet për krijimin edhe redaktimin e njësive në formatin MARC i japin bibliotekarit zakonisht mundësi të ndryshme për t'ia lehtësuar punën, nëse nevojitet që ai ta plotësojë ndonjë prej elementeve në numrin udhëheqës. Hollësitat për ta plotësuar dhe për ta interpretuar numrin udhëheqës, do ta japim në një botim të plotë.

Numri orientues. Njësitë në for-

matin MARC quhen njësi të etiketuara me tage. Para se të etiketohet, njësia në formatin MARC (në formatin komunikues MARC) duket krejtësisht ndryshe – ashtu si një fjali e gjatë. Në formatin komunikues, fushat nuk paraprihen me tage. Megjithatë, menjëherë pas numrit udhëheqës radhitet një grup i të dhënave që quhet numër orientues. Ky numër orientues tregon se çfarë tage gjenden në atë njësi dhe se në cilën pozitë gjenden (duke i llogaritur karakteret deri te secila pozitë ku fillon secila fushë). Numri orientues krijohet nga kompjuteri në mënyrë automatike, duke u bazuar në vetë njësinë bibliografike dhe duke u bazuar në informacionet e kataloguara. Nëse informacionet në njësinë bibliografike ndryshojnë, mund të ndryshojë, po ashtu, edhe numri orientues. Në një botim të plotë të kësaj broshure do të japim hollësitë se si funksionon ky numër.

Fusha 008. Fushës 008 i referohemi si fusha me gjatësi fikse të elementeve të të dhënave, ose fusha me kode fikse. Të 40-të karakteret e kësaj fushe përmbajnë informacione të rëndësishme, mirëpo në një formë të shkurtër. Edhe pse nuk përdoret ende në tërësi në katalogët në Internet, kjo fushë mund të përdoret për të identifikuar dhe për të nxjerrë njësi, të cilat përputhen me kritere të caktuara.

Për shembull, ekziston një kod në këtë fushë që tregon se një libër është i shtypur në shkronja të mëdha, një kod tjetër që identifikon vendin e botimit, një tjetër që identifikon materiale për të rinj, një kod që tregon gjuhën e tekstit, e kështu më radhë. Në një botim të plotë të kësaj broshure do të japim hollësitë se si funksionon kjo fushë.

PËRGATITI: BESIM J. KOKOLLARI

Koleksioni i Lëndëve Mësimore në mbështetje të Universitetit të Prishtinës

URIM SALLAUKA

Bibliotekat, në vendet me buxhet të kufizuar për blerje të koleksioneve, nuk arrijnë t'i plotësojnë nevojat e përdoruesve (studentëve), për shkak se nevojat për të rifreskuar koleksionet me tituj të rinj janë dinamike dhe të përhershme. Me shtimin e lëndëve të cilat ligjërohen në degë e departamente të ndryshme të universitetit, rriten edhe kërkesat për koleksionet lëndore, për aq sa rriten edhe shpenzimet.

Me hapjen e Qendrës së Bibliotekës Universitare, në kuadër të BKUK-së, janë rritur edhe nevojat për shpenzime më të mëdha nga buxheti për pasurim të koleksioneve, veçanërisht për blerje të koleksioneve të lëndëve mësimore. Në çdo fillimviti të ri akademik, Qendra e Bibliotekës Universitare do t'i japë përparësi, para së gjithash, pasurimit me koleksionet lëndore, për të plotësuar nevojat e studentëve në fusha dhe lëndë të caktuara. Në këtë kontekst, duhet pasur parasysh se Universiteti i Prishtinës formon departament të reja, dhe përveç sigurimi të titujve që vijojnë të jenë tituj për çdo vit të kërkuar nga studentët, duhet hulumtuar edhe nevojat për tituj të rinj për departament e drejtime të reja në universitet. Do të duhej që Qendra e Bibliotekës Universitare, jo vetëm

të ketë informacionin nga rektorati dhe fakultetet për çdo risi në fakultete, por të kenë një bashkëpunim të ngushtë për të dhënë edhe listën e titujve që përputhet me planprogramet në departamentet përkatëse të UP-së.

Pra, gjithë ky fenomen i ngritjes së cilësisë në mësim dhe të zgjerimit me degë të reja studimi, kërkon rritje të buxhetit, për shkak se do të shtohen kërkesat e përdoruesve.

Në këtë kontekst, Qendrës së Bibliotekës Universitare të Prishtinës, në këtë fillim, Zyra Amerikane në Prishtinë i ka dhënë një donacion për blerjen e këtyre koleksioneve. Për ta shfrytëzuar sa më racionalisht këtë donacion, përfaqësues të QBU-së kanë komunikuar intensivisht me përfaqësues të të gjitha fakulteteve të Universitetit të Prishtinës: dekanë, prodekanë, sekretarë, profesorë etj., duke mbledhur informacion për planprogramet e lëndëve, të cilat ligjërohen nëpër fakultete dhe literaturën që është e nevojshme, duke u mbështetur në këto planprograme. Stafi i QBU-së, me ndihmën edhe të stafit të BKUK-së, kanë hulumtuar dhe kanë gjetur shumicën e librave universitarë, për të cilët tituj pastaj kanë hartuar lista të veçanta për blerje, në funksion të pasurimit me koleksion të lëndëve mësimore. Gjithashtu, lista të veçanta janë krijuar edhe për koleksionet e tjera siç është edhe

koleksioni i librave referalë, si: fjalorë, enciklopedi, atlas etj. Po ashtu, janë hartuar lista edhe për koleksione në gjuhë të huaj, që është mjaft i kërkuar nga studentët tanë.

Koleksioni që tashmë është blerë, është vendosur te tavolina e qarkullimit, por ende nuk dihet se sa do t'i plotësojë nevojat e përdoruesve, për shkak të hapësirës së kufizuar. Ky koleksion: koleksioni i lëndëve mësimore dhe koleksioni referal, do të kenë kujdesin dhe sigurinë për përdorim; ekzistojnë kopje të mjaftueshme të shumë titujve që plotësojnë nevojat e studentëve. Titujt e këtyre koleksioneve do të ndërrohen ose pasurohen sipas nevojave që do të shfaqen në kontinuitet. Tashmë ekziston stafi që përkujdeset dhe mirëmban këtë koleksion të hapur, duke aplikuar pyetësorë për t'i verifikuar ndryshimet që do të duhej bërë në bazë të nevojave dhe kërkesave të studentëve. Për këtë koleksion – pra koleksionin e lëndëve mësimore, do të ketë tretman dhe politikë tjetër të qarkullimit, në krahasim me koleksionet e përgjithshme dhe ato referale. Shërbimi i Koleksioneve të Lëndëve Mësimore të QBU-së, që tash, ka filluar të bëhet një shërbim shumë i rëndësishëm në mbështetje të Universitetit të Prishtinës dhe të misionit të Bibliotekës Universitare.

Ndikimi temperaturës, lagështisë dhe ndriçimit në libër

SHQIPE ASLLANI

Në biblioteka dhe në arkiva shumë dëmtime janë të natyrës kimike. Temperatura, lagështia dhe ndriçimi janë tre komponentë kryesor prej të cilave varet shumë dëmtimi i letrës.

Temperatura e shpejton përqindjen e reaksioneve kimike, duke i dëmtuar këto materiale. Analizat e bëra në laborator, kanë treguar se dëmtimet e celulozës janë shkak i rritjes së temperaturës. Gjithashtu, nxehtësia dhe lagështia relative i nxisin agjentët biologjikë (insektet dhe mykun). Prania, në shkallë të lartë, e materieve organike dhe variacionet e nxehtësisë dhe të lagështisë relative mund të prishin strukturën e materialit bazë të letrës.

Materiali i mbledhur me përbërje nga origjina e shtazëve (si e tillë është letra e lëmuar ose xhelatinoze), po ashtu, është pjesë pjesërisht e ndjeshme në luhajtje të temperaturës dhe të lagështisë relative.

Ndryshimet e temperaturës dhe të lagështisë relative janë të dëmshme të shumica e koleksioneve, prandaj rekomandohet që në depo të mbahet temperatura nën normale. Nëse kjo nuk është e mundur, duhet të

kontribuohet në jetëgjatësinë e këtij materiali në mbajtjen konstante të temperaturës në specifikat e hapësirës.

Temperatura dhe lagështia e ajrit janë një fenomen në lidhje reciproke. Ndryshimi i temperaturës së ajrit, shoqërohet me ndryshime të menjëhershme të lagështisë relative. Letra, lëkura dhe materialet e tjera, prej të cilave përbëhen librat, na

paraqiten si materiale higroskopike (në veçanti letra). Përbërja e saj fizike dhe kimike varet nga shkalla e lagështisë atmosferike, e cila është në funksion të temperaturës së ajrit. Luhajtjet e mëdha e të shpeshta të lagështisë dhe të temperaturës së ajrit sjellin deformime të letrës dhe e prishin strukturën e saj. Merrritjen a zvogëlimin e lagështisë



Ndikimi i temperaturës dhe lagështisë në libër

së ajrit, fibrat celulozikë, bymehen ose tkurren dhe si rezultat ndryshon formati i fletës së letrës, deformohet dhe bëhet me valë (valëzohet). Me rritjen e lagështisë së ajrit rritet edhe lagështia e letrës dhe si rezultat, letra e humb fortësinë mekanike, pasi që tërheqja ndërmjet fibrave dobësohet. Përmbajtja e lagështisë së letrës ndikon në zhvillimin e mikroorganizmave në libër (të kërpudhave, të mykut etj.). Po ashtu, edhe thatësia e ajrit është e rrezikshme për materialet bibliotekare dhe arkivore.

Lagështia e ulët relative e ajrit.

Në lagështi të ulët relative të ajrit, letra jep lagështi dhe, si pasojë, ndryshohen vetitë e saj elastike; bëhet e thyeshme dhe e brishtë. Pra, në ajër shumë të thatë, shtresat ngjiten, bëhen të brishta e të thyeshme, marrin qarje të thella (letra pëlçet dhe grisit), bile edhe materialet e forta, siç është lëkura.

Lagështia e lartë relative e ajrit.

Nën ndikimin e lagështisë së lartë, ngjitësi në libër fryhet, fletët e librit çimentohen (ngjiten), materiali shkatërrohet (prishet). Procesi i ngjitjes (i bashkimit) të fletëve, është një fenomen shumë i ndërlikuar fiziko-kimik, dhe si shkak është mbufatja e substancave ngjitëse. Këto substanca ngjiten aq shumë saqë nuk është e mundur t'i ndash me metoda të zakonshme. Librat bëhen në formë blloku të

ngjitura dhe në fakt shkatërrohen. Rastet e ngjitjes së fletëve, më shpesh i hasim te letrat me ngjyrë. Në mënyrë që fletët e librit të mos deformohen dhe të mos dëmtohen, në vendet e ruajtjes së librave është e domosdoshme të mbahen në kushte të ruajtjes normale. Në këto kushte, letra përmban 6-8 % lagështi, ndërsa lëkura 12-14 % lagështi.

TEMPERATURA DHE LAGËSHTIA RELATIVE E AJRIT NË DEPOT E LIBRAVE

Kushtet normale të ruajtjes dhe të kontrollit të shpeshtë të gjendjes fizike të fondeve bib-

liotekare, ndikojnë në ruajtjen e fondeve për shumë vjet. Kushtet optimale për ruajtjen më të mirë të materialeve bibliotekare dhe arkivore janë: temperatura 14-20 0C, si dhe lagështia relative 50-60%. Nuk ka normativë ideale të temperaturës dhe të lagështisë relative, që u përgjigjet të gjithë tipave të materialeve. Temperaturat e larta e bëjnë letrën më të fortë dhe ndikojnë në vjetërsinë e saj. Është shumë vështirë që në biblioteka të krijohen kushte të temperaturës dhe të lagështisë relative për çdo tip materiali. Zakonisht, materialet bib-



Ndikimi enorm i temperaturës dhe lagështisë në libër

liotekare ruhen në kushte të mjedisit jo shumë të ftohtë, si dhe jo me shumë lagështi. Ajri duhet të qarkullojë normalisht në tërë sipërfaqen e librave dhe të mos përmbajë substanca të dëmshme kimike dhe përzjerje mekanike (pluhur, përbërje të squfurit etj.).

Ajrosja zakonisht kryhet me ndihmën e ventilimit ose thjesht nëpërmjet të hapjes së dritareve. Prandaj, luhatja e lagështisë së ajrit të jashtëm bëhet shkak për luhatjen e lagështisë relative të ajrit brenda ambientit ku ruhen fondet.

Vëzhgimet e shumta mbi gjendjen e fondeve bibliotekare, në bibliotekat e rëndësishme, dëshmojnë se:

- në lagështinë relative të ajrit më të ulët se 45%, për një kohë të gjatë, materialet e librave shkatërrohen, sepse letra thahet dhe thyhet lehtë;
- në lagështinë relative të ajrit 60-65%, letra përmban 5-7 % lagështi;
- në lagështinë relative të ajrit mbi 70%, materialet e librave mund të shkatërrohen nga shtresat e mykut dhe lehtë mund të zhvillohen bakteret;
- në lagështinë relative të ajrit mbi 80% humbin vetitë e letrës dhe fletët mund të ndahen nga ngjitësi;
- në lagështinë relative të ajrit 100%, letra përmban 30% lagështi relative.

Në rastet e rritjes së lagështisë së

ajrit, në depot e librave, ajrosja e lokalit duhet të bëhet me ajër të thatë (në ditë me diell), e jo me ajër të lagësht.

Në rastet ku në vendet e ruajtjes (depot) së librave, ajri mund të jetë i thatë, rekomandohet larja e shpeshtë e dyshemesë me leckë të lagur; preferohet që të vendosen enë të cekëta me ujë për t'u avulluar.

Për ta rregulluar temperaturën dhe lagështinë e ajrit, në vendet ku ruhen librat, është e domosdoshme të bëhen vrojtme të herëpashershme. Detyrë parësore e çdo konservuesi është alarmimi për gjendjen kritike të fondeve, sidomos të atyre të rralla, në mënyrë që të merren masa konkrete për shërimin (konservimin dhe restaurimin e tyre).

Ekzistojnë aparate të ndryshme për matjen e temperaturës dhe të lagështisë së ajrit. Temperatura dhe lagështia relative e ajrit zakonisht matet me Termohigrograf.

Ky është një aparat digjital për matjen e shpejt të temperaturës dhe të lagështisë relative nëpër depot e mëdha. Ky instrument është i përkryer për biblioteka, ku ajri është i kodicionuar dhe shërben për monitorimin e kushteve në objekt. Ky aparat mund të lexohet edhe prej një distance, dhe është, gjithashtu, shumë i lehtë të bartet dhe të vendoset në dollap ose në mure.

NDRIÇIMI NË DEPOT E LIBRIT

Në biblioteka dhe arkiva, ndriçimi duhet të jetë i rregullt dhe i kontrolluar. Është e pamundur që të mbrohem nga ndriçimi, porse mundësisht duhet ta mënjanojmë në minimum veprimin negativ të dritës. Hapësira ideale për ruajtjen e librave është ajo që nuk ka dritare dhe që ndriçohet vetëm me dritë artificiale. Në këtë hapësirë, dëmtimi nga drita është minimal. Eliminimi i një pjese të dritës (rrezatimit) në hapësira, bëhet në disa mënyra:

- montimi i xhamave të dritareve, që i absorbojnë rrezet ultravjollcë (UV) etj;
- ngjyrosja e dritareve me ngjyra që i absorbojnë rrezet ultravjollcë dhe rrezet e ndryshme (mund të përdoret çfarëdo ngjyre që nuk lëshon dritën të depërtojë, siç është dyoksidi i titanit, i cili i absorbon rrezet ultravjollcë);
- vendosja e roletave (të errëta) në dritare.

Librat nuk duhet të vendosen afër dritareve. Ato vendosen nëpër rafte (vitrina), që janë vertikale dhe jo horizontale. Është mirë që vitrinat të jenë me xhama që absorbojnë rrezet ultravjollcë dhe mundësisht me filtër.

Në ndërtesat e reja (bibliotekat) është i rregulluar ndriçimi. Në këto biblioteka ka ndriçim vetëm gjatë vizitës që u bëhet atyre.

Kujtesa vegjetale dhe minerale: e ardhmja e librit

(Qyteti i Aleksandrisë e ka luajtur rolin e mikpritësit për dijetarin dhe romancierin italian, Umberto Eko, i cili më këtë rast e ka mbajtur një ligjëratë në gjuhën angleze, ku ka folur për kujtesën në nivelin letrar, por edhe gjeografik, në Bibliotekën e Re të Aleksandrisë. Javorja "Al-Ahram" e ka botuar ligjëratën e tij, të cilën po e sjellim në shqip për revistën "Biblioetra".)

(vijon nga numri i kaluar)

Hiperteksti sigurisht se do të ndikojë që enciklopeditë dhe doracakët të bëhen të papërdorshëm. Dje, ishte e mundur që të kesh një enciklopedi të tërë në një CD-ROM; ndër-sa sot është e mundur ta kesh atë në linjë duke pasur parasysh përparësitë që mundësojnë "kros-referencat" dhe informacioni i pakorigjuar jo-linear. Të gjitha kompakt-disqet, plus edhe kompjuteri, do të zënë vetëm një të pestën e hapësirës që zihet nga një enciklopedi e shtypur. Një enciklopedi e shtypur nuk mund të transportohet lehtë sikur që mund të bartet një CD-ROM, dhe një enciklopedi e shtypur nuk mund të freskohet me të dhëna të reja. Dollapët që sot e zënë shtëpinë time, por edhe bibliotekat publike, që janë të mbushura me metra e metra enciklopedi do të eliminohen në një të ardhme të afërt, dhe nuk do të ketë arsye për ankesë pas zhdukjes së tyre. Le të kujtojmë se, për shumë njerëz, një enciklopedi multi-volume mund të konsiderohet ëndërr e pamundur, jo, jo vetëm për shkakun e shpenzimeve për volumet, por për harxhimin e hapësirës së mureve ku vendosen këto volume. Personalisht, duke pasur parasysh aktivitetin tim studioz si medievalist kam dëshirë të kem në shtëpi 221 volume të



Patrologia Latina-es së Mignit. Kjo është shumë e shtrenjtë, por ia dal disi. Por, çka nuk arrij t'ia dal është blerja e një banese të re, sepse në të kundërtën do të detyrohesha t'i eliminoj 500 vëllime të tjera normale.

Por, tash na mbetet çështja tjetër se a është e mundur që WWW-ja t'i zëvendësojë librat që janë për t'u lexuar? Prapë ne duhet të vendosim se a ka të bëjë kjo çështje me librat si objekte fizike apo si virtuale. Prapë na lejoni të marrim në konsideratë problemin fizik.

Lajm i mirë: librat do të mbeten të domosdoshëm, jo vetëm për letërsinë, por për çdo rrethanë ku nevojitet leximi i kujdesshëm, jo vetëm për të marrë informacionin, por gjithashtu për të spekuluar dhe për të reflektuar lidhur me të. Të lexosh në ekranin kompjuterik nuk është

njëjtë sikur ta lexosh librin. Mendo, për shembull, për procesin e leximit të një programi të ri kompjuterik. Zakonisht, programi është në gjendje të shfaqë në ekran të gjitha instrukcionet që ju nevojiten. Por, zakonisht, përdoruesit që dëshirojnë ta mësojnë programin duhet së pari ta shtypin atë, pra t'i shtypin ato instruksione dhe t'i bëjnë për lexim në formë të librit, ose edhe ta blejnë ndonjë doracak të shtypur. Është e mundur që të konceptohet një program vizual, i cili shpjegon shumë mirë se si të shtypet dhe të lidhet libri, por me qëllim që të merren këto instruksione se si të shkruajmë, si ta përdorim programin kompjuterik, neve na nevojitet libërth i shtypur.

Pasi që kisha kaluar rreth 12 orë në tastaturën e kompjuterit sytë e mi u bënë sikur dy toptha të tenisit dhe

ndjeva nevojën që të ulesha në një ulëse të butë dhe të lexoja gazetën, ose ndoshta një poezi të mirë. Prandaj, mendoj se kompjuterët janë duke e difuzuar një formë të re të literaritë, por ata janë të pafuqishëm që t'i kënaqin nevojat intelektuale, të cilat po i stimulojnë. Ju lutem, kujtoni të dy civilizimet e hershme, hebraike dhe arabe, të cilat janë të bazuara mbi librin, dhe kjo nuk qëndron e pavarur nga fakti se që të dyja kanë qenë civilizime nomade. Egjiptianët e vjetër kishin arritur t'i gdhendnin të dhënat e tyre në obeliskët e gurit: Mosoa dhe Muhamedi nuk kanë mundur. Nëse dëshironi ta kapërceni Detin e Kuq ose të shkoni nga Gadishulli Arabik në Spanjë, dorëshkrimi i mbledhur rrotull është instrumenti më praktik për regjistrimin dhe bartjen e të dhënave të *Biblës* ose *Kuranit* sesa obeliskët. Kjo është arsyeja pse këto dy civilizime të bazuara mbi librin e kanë privilegjuar shkrimin në vend të imazheve. Por, librat gjithashtu kanë edhe një përparësi tjetër në raport me kompjuterët. Edhe nëse shtypen në letër

moderne acidike, e cila qëndron rreth 70 vjet, ato (librat) janë më të qëndrueshme sesa materialet magnetike. Për më tepër, ato nuk vuajnë nga ndërprerjet e rrymës dhe bllokimet e ndryshme, e gjithësesi se janë edhe më rezistente ndaj goditjeve. Prandaj, libri ende përfaqëson mënyrën më ekonomike, më fleksibile, dhe më të pastër të transportimit të informacionit me çmim shumë të ulët. Komunikimi kompjuterik udhëton para jush; librat udhëtojnë me ju dhe me shpejtësinë tuaj. Nëse keni mbetur në një ishull të shkretë, ku nuk keni mundësi të qaseni në kompjuter, libri është instrument shumë i vlefshëm. Edhe nëse kompjuteri juaj ka bateri solare, ju nuk mund të lexoni përderisa qëndroni të ulur në një

luhatëse. Librat ende janë shoqëruetit më të mirë të vetmisë dhe të ditës së një nate më parë. Librat u përkasin atyre instrumenteve të cilat, që në momentin kur janë zbuluar, nuk janë përmirësuar më, sepse edhe sot e kësaj dite janë ashtu siç kanë qenë, si p.sh: çekani, thika, luga a gërshërët.

DY ZBULIMET E REJA, megjithatë, janë në prag që industrialisht të bëhen të shfrytëzueshme. Njëra është shtypja me kërkesë: pas skanimit të katalogëve të shumë bibliotekave a shtëpive botuese, lexuesi mund ta zgjedhë librin që i nevojitet, ndërsa operatori mund ta shtypë në çast butonin e caktuar dhe makina do të fillojë ta shtypë kopjen e vetme, duke e përdorur madhësinë e shkron-



jave ashtu siç dëshiron lexuesi. Kjo me gjasë do të mund ta ndërrojë tërë tregun e botimeve. Kjo ndoshta do të mund t'i eliminojë libraritë, por nuk do t'i eliminojë librat, as që do t'i eliminojë bibliotekat, që janë të vetmet hapësira a vende ku librat mund të gjenden për t'i skanuar a rishtypur. Thënë shumë thjesht: çdonjëri libër do të përpunohet sipas qejfit të blerësit, ngjashëm siç ka ndodhur edhe me dorëshkrimet e vjetra. Zbulimi i dytë është edhe e-libri, ku duke insertuar një mikro-kasetë në "shpinën" e librit ose duke ndërlidhur atë në Internet, dikush mund ta shtypë librin para syve tanë. Por, edhe në këtë rast, prapëseprapë ne do ta kemi librin, megjithëse në një formë tjetër nga ajo që e kemi sot, pra

ngjashëm sikur forma e sotme e krahasuar me dorëshkrimet e vjetra në pergamene, ose sikur foliot e para të Shekspirit të vitit 1623, që nuk mund të krahasohen me botimet e fundit të këtij autori nga Shtëpia Botuese Penguin. Mirëpo, deri më sot e-librat nuk janë dëshmuar të jenë komercialisht të suksesshme, ashtu siç kanë shpresuar themeluesit e tyre. Kam thënë se disa hakerë, të rritur në kompjuterë dhe të pamësuar që të shfletojnë libra, kanë arritur që të lexojnë kryeveprat më në zë të letërsisë në e-libër, por mendoj se ky fenomen prapëseprapë mbetet shumë i kufizuar. Në përgjithësi, njerëzit duket se pëlqejnë mënyrën tradicionale të leximit të një poezie a romani, pra në letërën e shtypur. E-librat ndoshta do të dëshmojnë suksesin e tyre sa i përket konsultimit të informacionit, siç ndodh me fjalorët apo dokumentet speciale. Këto ndoshta do t'u ndihmonin studentëve, të cilët obligohen që t'i marrin me vete dhjetë a më shumë libra kur shkojnë në mësim, por këto e-libra nuk do t'i zëvendësojnë llojet e tjera të librit, siç mund të jenë ato që ne dëshirojmë t'i lexojmë në shtrat para se të flemë.

Në fakt, tashmë ka shumë pajisje të reja teknologjike që prapë nuk kanë arritur t'i bëjnë të arriturat e mëparshme të papërdorshme. Automjetet ecin më shpejt se biçikletat, por ato nuk i kanë bërë biçikletat të papërdorshme, bile as të arriturat e reja teknologjike nuk mund ta bëjnë biçikletën shumë më të mirë sesa që ka qenë me parë. Ideja se teknologjia e re e dëmton ose e thyen atë të mëparshmen në mënyrë frekvente mund të cilësohet si e thjeshtëzuar. Pas zbulimit të fotografisë, piktorët nuk kanë ndjerë për obligim që të shërbejnë më si mjeshtër të reproduktimit të realitetit, por as nuk do të thotë se

zbulimi që e ka bërë Daguerri vetëm sa e ka inkurajuar pikturimin abstrakt. Ekziston tashmë një traditë e tërë në pikturën moderne që nuk do të ekzistonte pa modelet fotografike: mendo për shembull për hiper-realitetin. Këtu, realiteti shihet nga syri i piktorit nëpërmjet syrit të fotografisë. Kjo do të thotë se historia e kulturës nuk na shënon diçka që e ka mbytur atë të mëparshmen. Thënë më ndryshe, që invencioni i ri ta ketë ndryshuar atë të vjetrin.

Ta përmbyllim këtë temë sa i përket paqëndrueshmërisë së idesë për zhdukjen fizike të librave, por na lejon të themi se nganjëherë kjo frikë nuk e prek vetëm librin, por edhe materialin e shtypur në përgjithësi. Mirëpo, nëse rastësisht dikush mund të ketë menduar se kompjuterët e veçanërisht *word procesoret* do të ndikojnë në ruajtjen e drunjtëve, atëherë kjo do të mund të konsiderohej vetëm si dëshirë. Në të vërtetë, kompjuterët inkurajojnë prodhimin e materialit për shtypje. Kompjuteri krijon tip të ri të prodhimit dhe difuzionit të dokumenteve të shtypura. Me qëllim të rileximit të tekstit dhe të korrigjimit adekuat të tij, nëse nuk është vetëm një letër, shfaqet kërkesa për ta shtypur atë, pastaj për ta rilexuar, pastaj për ta rikorrigjuar në kompjuter e më pastaj për ta shtypur përsëri. Nuk mendoj se dikush do të jetë në gjendje të shkruajë një tekst rreth njëqind faqe dhe ta korrigjojë në mënyrë adekuate pa e shtypur shumë herë.

Sot, ekzistojnë poetika të reja hipertekstuale, sipas së cilave edhe libri-për t'u-rilexuar, edhe poezia, mund të transformohet në hipertekst. Në këtë pikë ne po rrëshqasim në çështjen e dytë, pra, kur më problemi nuk mund të shihet vetëm si fizik, por hyn në brengosjen për vetë natyrën e aktivitetit kreativ, procesit të leximit. Prandaj, me qëllim që ta zbulojmë këtë shtresë të pyetjeve së pari duhet të vendosim se çka kuptojmë apo nënkuptojmë me atë që po e

quajmë lidhje hipertekstuale. Të vërejmë këtu se, nëse çështja ka të bëjë me mundësinë e interpretimeve finite apo infinite që vijnë nga ana e lexuesit, atëherë duhet të thuhet se kjo nuk diskutohet këtu. Kjo më shumë thuhet se ka të bëjë me poetikën e Xhojsit, ku mund të thuhet se teksti i tij *Zgjimi i Fineganit* është thuhet se shkruar për ata lexues idealë, të cilët në njëfarë mënyre që më parë janë prekur nga një pagjumësi (insomnia) ideale. Kjo çështje ka të bëjë me kufijtë e interpretimit, të leximit dekonstruktiv si dhe tej-interpretimit, çështje së cilës i kam kushtuar shumë shkrime të tjera. Jo: ajo që këtu është duke u marrë në konsideratë janë rastet në të cilat infiniteti, ose fundi i fundit me bollëkun e shumtë të interpretimeve, të jetë pjesë jo vetëm të iniciativës së lexuesit, por gjithashtu edhe mobilitetit fizik të tekstit, i cili është prodhuar në atë mënyrë që vetëm të rishkruhet. Me qëllim që të kuptojmë se si funksionojnë këto tekste të këtyre zhanreve ne duhet të vendosim se a është universi tekstual për të cilin ne po diskutojmë finit apo i kufizuar, i kufizuar, por virtualisht i pakufizuar, infinit, por i kufizuar ose i pakufizuar dhe infinit.

Së pari, duhet ta bëjmë dallimin ndërmjet sistemeve dhe teksteve. Sistemi, për shembull sistemi gjuhësor, është tërësia e mundësive që dalin nga një gjuhë natyrale. Grumbulli a sasia finite e rregullave gramatikore ia mundëson folësit që të prodhojë numër infinit të fjalive, dhe çdo gjë a send linguistik mund të interpretohet nga sende të tjera linguistike a semiotike - fjala nga definicioni, një ngjarje nga një shembull, një shtazë a një lule nga një imazh, e kështu me radhë, e kështu me radhë. Ta marrim për shembull fjalorin enciklopedik. Ai mund ta definojë qenin si gjitar, dhe pastaj ju duhet të kërkonit për gjitarët, e nëse aty gjitarët janë definuar si shtazë, ju duhet të kërkonit në rend për shtazët. Në të



njëjtën kohë, veçantitë e qenit mund të jenë të shpërfaqura nëpërmjet imazheve të qenve të llojeve të ndryshëm; nëse për shembull thuhet se ky lloj qeni jeton në Lapland, atëherë ju duhet të kërkonit Laplandin për të ditur se ku gjendet ai e kështu me radhë. Sistemi është finit, enciklopedia fizikisht është limite, por virtualisht jolimite në kuptim të asaj se ju mund të lundroni në një lloj lëvizjeje të hapur lundruese, *ad infinitum*. Në këtë kuptim, sigurisht se të gjitha librat përfytyrueshëm janë përpiluar nga dhe përbrenda një fjalori të mirë dhe një gramatike të mirë. Nëse keni aftësi që ta përdorni mirë fjalorin e gjuhës angleze ju mund ta shkruani *Hamletin*, dhe këtë do të mund ta bënit thuhet se sikur që dikush e ka bërë para jush. I jepni të njëjtin sistem tekstual Shekspirin dhe një nxënësi, ata do të gjejnë të njëjtat mundësi që do ta prodhojnë *Romeon dhe Xhulietën*.

Gramatikat, fjalorët dhe enciklopeditë janë sisteme: me anë të përdorimit të tyre ju mund të prodhoni të gjitha tekstet që doni t'i prodhoni. Por, vetë teksti nuk është një sistem enciklopedik a linguistik. Një tekst i caktuar redukton mundësitë infinite ose të papërcaktuar të sistemit, për ta ndërtuar kështu një univers të

mbyllur. Nëse unë e shqiptoj fjalën “Këtë mëngjes për kafjall kam pasur...”, për shembull, fjalori më lejon mua një listë të shumë artikujve, ta zëmë që të gjithë organikë. Por, nëse definitivisht e hartoj tekstin tim dhe e shqiptoj, “Këtë kafjall hëngra bukë dhe gjalpë”, - atëherë unë e kam përjashtuar djathin, ajvarin, ëmbëlsirat dhe mollët. Teksti kastron (pret) mundësitë infinite të sistemit. *Netët arabe* mund të interpretohen në shumë, shumë mënyra, por rrëfimi ndodh në Lindjen e Mesme e jo në Itali, dhe tregon për, le të themi, të bëmat e Ali Babës ose të Shehrezades dhe nuk merret me kapitenin që është i vendosur ta zërë një balenë të bardhë apo për poetin tuskan që e viziton Ferrin, Purgatorin dhe Parajsën.

Të marrim përrallën, *Kësulëkuqja*. Teksti fillon me dhënien e një shume të karaktereve dhe situatave - vajza e vogël, nëna, gjyshja, ujku, mali, - dhe nëpërmjet një serie të hapave finit arrihet deri te zgjidhja. Sigurisht, ju mund ta lexoni një përrallë si një alegori dhe t'i atribuoni asaj domethënie të ndryshme morale për ngjarjet dhe për aksionet e karaktereve, por ju nuk mund ta transformoni *Kësulëkuqen* në *E përhitura*. *Zgjimi i Fineganit* sigurisht se është i hapur për shumë interpretime, por është e sigurt se kurrë nuk do t'iu sigurojë me një demonstrim të teoremës së Fermatit apo me një bibliografi komplete të Vudi Allenit. Kjo mund të duket triviale, por gabimi radikal i shumë dekonstruksionistëve ka qenë mësimi se mund të bëhet gjithçka me tekstin. Kjo zhurmshëm është diçka false.

Tash të supozojmë se një tekst finit dhe i kufizuar është organizuar hipertekstualisht me anë të shumë lidhjeve që bashkojnë fjalët me fjalët e tjera. Në një fjalor apo në një enciklopedi fjala *ujk* potencialisht ndërlidhet me çdo fjalë tjetër që përbën ndonjë pjesë të definicionit të mundshëm apo përshkrimit të mund-

shëm (ujku është i lidhur për shembull me shtazët, me gjitarët, me egërsirat, me këmbët, gëzofin, dy sytë, me malet, me emrat e vendeve në të cilat ekzistojnë ujkit etj.). Në *Kësulëkuqen*, ujku mund të lidhet vetëm me seksionet tekstuale në të cilat ai shfaqet apo ku në mënyrë eksplicite evokohet. Seritë e lidhjeve të mundshme janë finite dhe të kufizuara. Si mund të përdoren strategjitë hipertekstuale për ta “hapur” një tekst finit dhe të kufizuar?

Mundësia e parë është që teksti fizikisht të bëhet i pakufizuar, në kuptimin që tregimi mund të pasurohet me kontribute suksesive të autorëve të ndryshëm dhe në kuptimin e dyfishtë, le të themi në mënyrë dy-dimensionale apo tre-dimensionale. Me këtë nënkuptoj kur për shembull te *Kësulëkuqja* autori i parë e propozon situatën fillestare (vajza hyn në pyll) dhe pastaj kontribuues të ndryshëm mund të zhvillojnë rrëfimin njëri pas tjetrit, për shembull, duke bërë që vajza të mos e takojë ujkun, por Ali Babën, për të hyrë që të dy në kështjellën e magjishme, ku pastaj do të përlesheshin me krokodilin magjik, e kështu me radhë, ku, në këtë mënyrë, rrëfimi të vazhdonte me vite të tëra. Por, teksti gjithashtu mund të jetë infinit në kuptim të asaj se çdo veçim narrativ, për shembull, kur vajza hyn në pyll, shumë autorë mund të bëjnë zgjedhje të ndryshme. Për ndonjë autor vajza do të mund ta takojë Pinokion, për ndonjë tjetër ajo mund të transformohet në një mjellmë, apo të hyjë në ndonjë piramidë dhe të zbulojë thesarin e djalit të Tutankamenit.

Kjo sot është e mundur, dhe ju mund të gjeni në Internet disa shembuj interesant të këtyre lojërave letrare. NË KËTË PIKË dikush mund ta ngritë çështjen që ndërlidhet me vetë nocionin e autorësisë dhe veprës së artit, si një tërësi organike. Por, dua thjesht ta informoj audiencën time se kjo tashmë ka ndodhur në të kaluarën

pa e penguar as autorësinë as tërësinë organike. Shembulli i parë është ai i *Commedia dell'arte*-s italiane, në të cilën mbi një *canovaccio*, që është një përmbledhje e tregimit fillestar, çdo shfaqje, që varej nga disponimi dhe fantazia e aktorëve, ka qenë e ndryshme nga tjetra, prandaj nuk bëhej e mundur të identifikohesh edhe vetëm një vepër me të njëjtin autor që quhej *Arlexchino servo di due padroni* dhe që mund të shënonte seritë e papenguara të shfaqjeve, por që shumica prej tyre humbeshin ose sigurisht se ishin të ndryshme nga njëra-tjetra.

Një shembull tjetër i kësaj mund të



jetë edhe sesioni i lëmshtit të xhazit. Ne mund të besojmë se dikur ka qenë një performansë e privilegjuar e *Basin Street Blues* dhe se vetëm incizimi i tyre i fundit ka mbijetuar, por, ne e dimë se kjo nuk është e saktë. Ka pasur aq shumë *Basin Street Blues*, aq sa ka pasur performansa të tyre, dhe do të ketë edhe në të ardhmen shumë të tjera, të cilat nuk do t'i dimë, që kur dy apo më shumë interpretues arrijnë të bashkohen dhe të shpërfaqin versionin e tyre personal dhe inventiv të një teme origjinale. Ajo që dua të them këtu është se ne tashmë jemi mësuar me idenë e

mungesës së autorësisë në artet kolektive popullore, në të cilat çdo pjesëmarrës shton diçka, me përvojën e pambarim të rrëfimeve të xhazit. Mënyrat e tilla të jetësimit të aktivitetit të lirë janë të mirëpritura dhe përbëjnë një pjesë të shtresës kulturore të shoqërisë.

Por, këtu kemi të bëjmë me një dallim ndërmjet jetësimit apo implementimit të aktivitetit të prodhimit të teksteve infinite dhe të pakufizuara dhe ekzistencës së teksteve tashmë të prodhuara, të cilat ndoshta mund të interpretohen në mënyra infinite, por që fizikisht janë të kufizuara.

Edhe në kulturën tonë bashkëkohore ne pranojmë dhe vlerësojmë, sipas standardeve të ndryshme, edhe një performansë të re të Pestës së Betovenit dhe një Sesione të ri të Lëmshit me temë të Basin Street-save. Në këtë kuptim, nuk shoh se si një lojë fascinuese e prodhimit kolektiv, të tregimeve infinite në Internet mund të na e mohojë letërsinë autoriale dhe artin në përgjithësi.

Për më tepër, ne po marshojmë drejt një shoqërie më liberale, në të cilën kreativiteti i lirë do të bashkëjetojë me interpretimin e teksteve tashmë të shkruara. E pëlqej këtë. Por, ne, nuk mund të themi se kemi zëvendësuar një diçka të vjetër me një diçka të re. Ne i kemi të dyja.

Shikimi i televizionit është një lloj tjetër i aktivitetit që nuk ka të bëjë asgjë me shikimin e një filmi në kuptimin tradicional. Mjeti hipertekstual na e mundëson neve që të krijojmë tekste të reja, të cilat nuk kanë të bëjnë asgjë me aftësinë tonë për t'i interpretuar tekstet para-ekzistuese. Jam përpjekur me ngulm që të gjej një shembull të situatave tekstuale të pakufizuara dhe finite, por nuk kam arritur ta bëj një gjë të tillë.

Në fakt, nëse ju keni një numër infinit të elementeve në lojë, atëherë me çfarë e kufizoni vetveten në prodhimin e një universi finit. Kjo thuhet është çështje teologjike, një lloj i një sporti kozmik, në të cilin, njëri, ose

Njëri, mund të jetësojë çdo performansë të mundshme, por duke ia përshkruar vetvetes një rregull, pra limitin, duke gjeneruar kështu një univers shumë të vogël e të thjeshtë. Megjithatë, më lejoni të marrë në shqyrtim një mundësi tjetër, e cila në dukje të parë premtun një numër infinit të mundësive me një numër finit të elementeve, ngjashëm sikur sistemi semiotik, por që në realitet vetëm sa e ofron një iluzion të lirisë dhe të kreativitetit.

Hiperteksti mund ta japë iluzionin e hapjes edhe të tekstit më të mbyllur: tregimi detektiv mund të strukturohet në atë mënyrë në të cilën lexuesit e tij mund ta selektojnë zgjidhjen e tyre, duke vendosur në fund se kujt i bie faji: shërbëtorit, priftit, detektivit, narratorit, autorit apo lexuesit. Ata edhe mund ta ndërtojnë historinë e tyre personale. Mirëpo, kjo ide nuk mund të thuhet se është e re. Para zbulimit të kompjuterëve, poetët dhe rrëfimtaret kanë ëndërruar për tekstin totalisht të hapur, ku lexuesit do të kishin mundësi të bënin rikomponime të ndryshme të paskajshme. E tillë ishte ideja e *Le Livre*, e lartësuar nga Mallarmé. Ndërsa, Raymond Queneau gjithashtu zbuloi një algoritëm kombinatorik me anë të të cilit bëhej e mundur që të komponoheshin, nga një numër i caktuar i vargjeve, miliona poezi. Në vitet e hershme të gjashtëdhjetës, Maks Saporta e kishte

shkruar dhe botuar një roman, faqet e të cilit mund të zhvendoseshin për të komponuar tregime të ndryshme, ndërsa Nani Balestrini i dha kompjuterit një listë të çkatërruar (të palidhur) të vargjeve, të cilat pastaj makina do t'i kombinonte në mënyra të ndryshme për të kompozuar poezi të ndryshme. Shumë muzikantë bashkëkohorë kanë prodhuar nota muzikore me anë të manipulimit, ku një e tillë mund të komponojë shfaqje të ndryshme muzikore.

Të gjitha këto tekste fizikisht të lëvizshme japin impresionin e një lirie absolute të pjesa e lexuesit, por ky është vetë një impresion, një iluzion i lirisë. Makinaria që ia mundëson dikujt që të prodhojë një tekst infinit me një numër finit të elementeve ka ekzistuar me mileniume dhe kjo makinari është *alfabeti*. Duke e përdorur alfabetin me numër të kufizuar të germave mund të prodhohen biliona tekste dhe kjo në mënyrë ekzakte është ajo që është bërë që nga Homeri deri në ditët e sotme. Në të kundërtën e kësaj, teksti-shtysë që nuk na sjell neve letra apo fjalë, por me sekuenca të parathemeluara të fjalëve, ose të faqeve, nuk na jep liri të krijojmë gjithçka që duam. Ne jemi të lirë që të lëvizim copat e themelutara tekstuale në një numër më të lartë të arsyeshëm të mënyrave. Mobili i Calderit është fascinues, jo pse ai prodhon një numër infinit të



lëvizjeve të mundshme, por se ne admirojmë në të rregullën e hekurt që imponohet nga artisti, sepse mobiliteti lëviz vetëm në atë mënyrë siç ka dëshiruar Calderi.

Në kufirin e fundit të tekstualitetit të lirë, mund të ketë një tekst që fillon si i mbyllur, le të themi, *Kësulëkuqja* apo *Netët Arabe*, dhe ku Unë, lexuesi, mund ta modifikoj atë sipas prirjeve të mia, duke e elaboruar kështu një tekst të dytë, i cili më nuk është i njëjti me të parin, autor i së cilit është vetja ime, megjithëse afirmimi i autorësisë sime bëhet armë kundër konceptit të autorësisë së përcaktuar. Interneti është i hapur për eksperimente të tilla dhe shumica e tyre mund të jenë të bukura dhe shpërblyese. Askush nuk e ndalon askënd që të shkruajë një tregim ku Kësulëkuqja do ta asgjësonte ujkun. Askush nuk na ndalon neve nga mbledhja së bashku e tregimeve të ndryshme në një lloj të laramanisë narrative. Por, kjo nuk ka të bëjë asgjë me funksionin real dhe me sharmin e thellë të librave.

LIBRI NA E OFRON TEKSTIN, i cili, duke qenë i hapur për shumë interpretime, na tregon diçka që nuk mund të modifikohet. Supozoni se jeni duke e lexuar *Luftën dhe paqen* të Tolstoit: ju me ngulm dëshironi që Natasha t'mos e pranojë vardisjen e faqeziut Anatolij; ju ndoshta me ngulm do të dëshironit që personi i madhërisëm që është Princi Andrej të mos vdesë dhe që Ai dhe Natasha të jetojnë së bashku përgjithmonë. Nëse do ta kishit *Luftën dhe paqen* në hipertekst dhe në CD-ROM interaktiv, ju mund ta rishkruanit rrëfimin tuaj sipas dëshirës; ju mund të krijonit një numër të pacaktuar të "luftës dhe paqes", ku Pier Besushov arrin ta vrasë Napoleonin, ose, sipas dëshirës dhe prirjeve tuaja, Napoleoni definitivisht e mund gjeneralin Kutusov. Çfarë lirie, çfarë dallie! Çdo Bovard apo Pekushe do të bëhej Flobër!

Por, kur kemi të bëjmë me libër tashmë të shkruar, fati i të cilit është për-

caktuar me represion, me vendimin autorial, ne nuk mund ta bëjmë një gjë të tillë. Ne jemi të detyruar ta pranojmë fatin dhe të kuptojmë se nuk jemi në gjendje ta ndryshojmë fundin. Një roman interaktiv dhe hipertekstual na lejon që të praktikojmë lirinë dhe kreativitetin, dhe shpresoj se një aktivitet i tillë inventiv do të implementohet (jetësohet) në të ardhmen nëpër shkolla. Por, një roman i shkruar dhe i përfunduar siç është *Lufta dhe paqja* nuk na përball me mundësitë e pakufizuara të imagjinatës sonë, por na përball më shumë me rregullat e ashpra të jetës dhe vdekjes.

Ngjashëm, në *Të mjerët*, Viktor Hygo na e sjell përshkrimin e bukur të betejës së Vaterlosë. Vaterloja e Hygos



është e kundërta e Stendalit. Stendali në *La Chartreuse de Parme*, e shikon betejën nëpërmjet syrit të heroit të tij, i cili shikon nga brenda ngjarjen, mirëpo nuk e kupton kompleksitetin e saj. Në të kundërtën, Hygo përshkruan betejën nga pikëpamja e Zotit, duke e përcjellë atë në çdo detaj, duke e dominuar kështu perspektivën narrative të tij në tërë skenën. Hygo jo vetëm që e di se çka ka ndodhur, por edhe se çka mund të ndodhte dhe që në fakt nuk ka ndodhur. Ai e di se, nëse Napoleoni do ta dinte se prapa majës së malit Shën Gjoni ishte shkëmb

mburojë e gjeneral Milhudit nuk do të dorëzohej para këmbëve të ushtrisë angleze, por informacioni i tij për këtë ngjarje ishte i pakët ose kishte humbur. Hygo e di se nëse bariu, i cili ishte bërë kallauz për gjeneralin Von Bulou, do të kishte sugjeruar një rrugë tjetër, atëherë armata prusiane nuk do të arrinte me kohë që më pastaj të shkaktonte humbjen e francezëve. Në fakt, në ndonjë luajtje roli dikush mund ta rishkruante Vaterlonë në atë mënyrë që Grushi të arrinte me burrat e tij për ta mbrojtur Napoleonin. Por, bukuria tragjike e Vaterlosë është ajo se lexuesit e ndiejnë se gjërat ndodhin pavarësisht nga dëshirat e tyre. Sharmi i letërsisë tragjike është ai se e ndiejmë se heronjtë e saj do të mund t'i shmangeshin fatit të tyre, por nuk arrijnë ta bëjnë një gjë të tillë nga dobësia e tyre, fisnikëria ose edhe verbëria. Përveç kësaj, Hygoja na tregon se, "një marramendje e tillë, një gabim i tillë, një gërmadhë e tillë, një rënie e tillë që e ka habitur tërë historinë është diçka si e bërë pa shkak? Jo... zhdukja e atij njeriu të madh ka qenë e domosdoshme për ardhjen e shekullit të ri. Dikush, për të cilin askush s'ka dyshim, është kujdesur për këtë ngjarje... Zoti ka kaluar andej, *Dieu a passé*. Kjo është ajo që na e tregon çdo libër madhështor, se Zoti ka kaluar andej-pari, dhe se Ai ka kaluar andej edhe për besimtarin edhe për skeptikun. Prandaj, janë librat që ne nuk mund t'i rishkruajmë, sepse funksioni i tyre është që të na mësojnë për domosdonë, dhe vetëm nëse ato respektohen ashtu siç janë mund të na pajisin me një urtësi (mençuri) të tillë. Mësimi i tyre represiv është i domosdoshëm për të arritur një nivel ose gjendje të lartë të lirisë morale dhe intelektuale. Shpresoj dhe dëshiroj që *Biblioteka e Aleksandrisë* do të vazhdojë të ruajë këtë lloj librash, me qëllim që t'u sigurojë lexuesve të rinj përvojën e pazëvendësueshme të leximit të tyre. Jetë të gjatë për këtë tempull të kujtesës vegjetale.

Nga anglishtja: Nysret KRASNIQI

GRANTI I ZYRËS AMERIKANE PËR BIBLIOTEKËN KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE TË KOSOVËS

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës ka marrë një grant 70, 000 dollarësh amerikan për të pasuruar fondet e Qendrës së Bibliotekës Universitare me tituj që gjenden në tregun vendor dhe në atë ndërkombëtar. Ky grant është pjesë e ndihmës së mëhershme të Zyrës Amerikane në Prishtinë për të mbështetur krijimin dhe zhvillimin e Qendrës së Bibliotekës Universitare në mënyrë që ndikimi i saj të jetë sa më i efektshëm në procesin arsimor të Universitetit e Prishtinës. Nga ky fond janë shpenzuar 35, 960 dollarë në bler-



je e revistave elektronike, të cilat gjenden në bazat e të dhënave të kompanive shërbyese EBSCO host

dhe Gale. Pjesa tjetër grantit është shpenzuar për blerjen e librave universitarë.

AGRON LOXHA I DHURON BKUK-së TITIJ TË GAZETAVE ANGLEZE QË FLASIN PËR KOSOVËN

(Prishtinë, maj – nëntor 2006)

Ish-përgjegjësi i Qendrës Informative të Kosovës me seli në Londër intelektual i Agron Loxha, i dhuroi Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës një numër ekzemplarësh të gazetave angleze: "The Daily Telegraph", "The Independent", "The Times", "The Observer", "The Guardian", "The Sunday Times", të cilat japin informacione për periudhën e luftës në Kosovë 1998-1999. Këto gazeta, përveç që kanë një rëndësi të veçantë në kuadër të pasurisë së fondeve, do të zënë vend të rëndësishëm në kuadër të realizimit të projektit të BKUK "Kujtesa e Kosovës".

PËRFAQËSUESJA E EIFL.NET VIZITOI KOSOVËN



(Prishtinë, 1 shtator 2006)

Në përpjekje për ristrukturimin e Konsorciumit të Bibliotekave Elektronike të Kosovës, që vepron në kuadër të BKUK-së, Bibliotekën e vizitoi përfaqësuesja e eIFL.net - Monika Segbert. Vizita e saj njëditore në BKUK, më 1 shtator 2006, u përqendrua në biseda lidhur me zhvillimin e mëtejshëm të Konsorciumit dhe rizgjedhjes së organeve drejtuese të tij. Vizita e saj, po ashtu u përqendrua edhe në një takim të organizuar me përfaqësues të ndryshëm të bibliotekave e të institucioneve të Kosovës, përfaqësues të rek-

toratit, të fakulteteve, bibliotekave publike, bibliotekave private, etj.

Në këta takime të pranishmit u njoftuan me misionin dhe vizionin e eIFL.net, më mundësinë e shfrytëzimit të burimeve elektronike falas, dhe atyre me pagesë, me një çmim të volitshëm për tregun kosovar, me mundësinë e krijimit të depoziturave digjitale për nevoja institucionale, për programet e hapura në internet si sistemet e automatizuara, etj., trajnimet e ndryshme, si dhe shumë shërbime të tjera që ofron eIFL.net për konsorciumet - anëtare të saj.

NË BKUK U PROMOVUAN BOTIMET E QENDRËS SË STUDIMEVE TAURIS



(Prishtinë, 6 tetor 2006)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës organizoi promovimin e tre librave të rrallë: Owen Pirson "Shqipëria nën okupim dhe në luftë 1940-1945"; Artur Evans "Iliria e lashtë" dhe Owen Person "Shqipëria si diktaturë dhe demokraci", të gjitha këto në gjuhën angleze. Librat e përruruar, që janë vlerësuar si shumë të rëndësishëm, janë botime

të Qendrës së Botimeve Shqiptare në Londër Tauris.

Në këtë promovim, referuan dr. Emine Bakalli, Avni Spahiu dhe Enver Hoxhaj. Ndërsa, Bejtullah Destani, udhëheqës i Qendrës për Studime Shqiptare në Londër, foli për autorët e këtyre librave të promovuar, dhe për rëndësinë e botimit të literaturës që flet për çështjen shqiptare nga autorë të huaj.

FILLOI PUNËN QENDRA E BIBLIOTEKËS UNIVERSITARE

Prishtinë, 17 tetor 2006

Më 17 tetor 2006 filloi punën Qendra e Bibliotekës Universitare, në kuadër të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, ndërsa hapja solemne pritet të bëhet me rastin e 62-Vjetorit të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës.

Qendra e Bibliotekës Universitare i ka vënë shërbimet e veta në dispozicion të të gjithë studentëve e të personelit të Universitetit të Prishtinës, si dhe hulumtuesve dhe studiuesve të ndryshëm nga vendi e bota.



Qendra e Bibliotekës Universitare ofron një varg shërbimesh të reja për përdoruesit e bibliotekës, nëpërmjet Sektorit të Referencave, Sektorit të Koleksioneve Lëndore, Shërbimit të kompjuterëve, burimeve elektronike, si dhe huazimit të materialeve.

VIZITË E DREJTORIT TË BKUK-SË NË SLOVENI

(Lubjanë, 29 tetor 2006)

Drejtori i BKUK-së Prof. dr. Sali Bashota, në kuadër të vizitës në Slloveni, është pritur nga drejtori i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Sllovenisë - z. Lenart Shetinc.

Gjatë këtij takimi është biseduar për bashkëpunimin ndërmjet këtyre dy institucioneve më të larta bibliotekare, duke pasur parasysh traditën e frytshme të bashkëpunimit që kanë pasur këto biblioteka para disa viteve.

Në këtë takim, është arritur pajtimi për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet BKUK-së dhe BKUS-ës në fushën e arsimit bibliotekar, në fushën e shkëmbimit të materialeve bibliotekare, si dhe të përvojës në fushën e restaurimit dhe konservimit.

* * *

Drejtori i BKUK-së ka pasur një takim edhe në Maribor në familjen e njohur të Mikel Kaçinari, me ç'rast është biseduar me zonjën Gonxhe Kaçinari për dorëzimin e bibliotekës personale të intelektualit dhe mendimtarit të njohur dr. Krist Maloki, i cili i kishte lënë amanet zonjës së tij Fraja Maloki, që ky fond i bibliotekës t'i dorëzohet BKUK-së në Prishtinë.

RISTRUKTUROHET KONSORCIUMI I BIBLIOTEKAVE ELEKTRONIKE TË KOSOVËS

(Prishtinë, 4 tetor 2006)

Pas vizitës së përfaqësueses së eIFL.net, më 4 tetor 2006, Konsorciumi i Bibliotekave Elektronike u riorganizua, duke krijuar bordin prej nëntë anëtarëve, si dhe koordinatoren e këtij Konsorciumi për Kosovën. Koordinator për Kosovën u zgjodh Besim Kokollari, ndërsa

anëtarët e bordit u zgjodhën: Osman Gashi, prodekan i Fakultetit të Filologjisë, Fatime Mehmeti, përfaqësuese e bibliotekave publike, Shkurtë Kadriu, përfaqësuese e Ministrisë së Kulturës, Malush Mjaku, përfaqësues i Ministrisë së Arsimit, Luan Ahma, përfaqësues nga Rektorati, Svetlana Breca, për-

faqësuese e Zyrës së ShBA-ve në Prishtinë, Bukuriye Haliti dhe Gjon Berisha, përfaqësues të BKUK-së, dhe Muhamet Çitaku, përfaqësues i universiteteve private.

Struktura e re e Konsorciumit premtan një bashkëpunim të fuqishëm mes institucioneve bibliotekare e informative të Kosovës.

TAKIMI VJETOR NDËRKOMBËTAR PËR ISBN



(Paris, 6-7 nëntor 2006)

Përgjegjësja për ISBN në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës - Lavdie Rrahmani, me ftesë zyrtare nga Agjencia Ndërkombëtare e ISBN-së, ka marrë pjesë në Takimin Gjeneral të ISBN-së, që është mbajtur në Paris, më 6 dhe 7 nëntor të vitit 2006.

Në këtë takim morën pjesë përfaqësues nga shumica e Agjencive Nacionale - përgjegjës për Numrin Ndërkombëtar të Standardizuar të Librit (ISBN) dhe pati agjendë të ngjeshur me prezantime të ndryshme rreth çështjeve kryesore të funksionimit të sistemit ndërkombëtar të ISBN-së.

Rëndësi të posaçme këtij takimi i dha prezantimi dhe diskutimi i gjerë nga pjesëmarrësit rreth çështjes së implementimit të ISBN-së 13 shifror.

Me kërkesën e Bordit Udhëheqës të agjencisë Ndërkombëtare të ISBN-së nga ana e përgjegjësit të ISBN -së për Kosovë është përgatitur raport me shkrim për vitin 2006.

KONFERENCA NDËRKOMBËTARE: GLOBALIZIMI, DIGJITALIZIMI, QASJA DHE KONSERVIMI I TRASHËGIMISË KULTURORE



(Sofje, 7-10 nëntor 2006)

Në konferencën ndërkombëtare:

"Globalizimi, Digjitalizimi, Qasja dhe Konservimi i trashëgimisë kulturore", e organizuar nga Shoqata e Bibliotekarëve së Bullgarisë, si dhe Unioni i Bibliotekave dhe Shërbimeve Informative, të mbajtur në Sofje të Bullgarisë, më datën 7 -10 nëntor 2006, me financim të Zyrës Amerikane në Prishtinë, morën pjesë edhe përfaqësues nga BKUK-ja - Bedrije Mekolli dhe Urim Sallauka. Në këtë konferencë morën pjesë përfaqësues të mbi 30 shteteve të botës, të cilët prezantuan punën dhe veprimtarinë e tyre që zhvillohet në biblioteka e tyre.

Urim Sallauka, në takimin me pjesëmarrës të Shoqatave të Bibliotekarëve Senior, prezantoi informacion për historikun dhe për proceset e zhvillimit nëpër të cilin po kalon Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës. Qëllimi i kësaj konference ishte rritja e bashkëpunimit ndërmjet bibliotekave të Evropës Juglindore, si dhe kërkimi i formave për hartimin e projekteve me interes të përbashkët. Konferenca, në këtë kontekst, ishte përqendruar në ligjëratat dhe diskutime për zhvillimet bibliotekare të vendeve pjesëmarrëse, nga ekspertë, profesorë, punonjës e studentë nga fusha e bibliotekarisë.

TRAJNIM PËR EBSCO NË PRAGË

(Pragë, 27-28 nëntor 2006)

Me ftesë të Kompanisë EBSCO, për një trajnim dyditorë në Pragë morën pjesë përfaqësuesit e BKUK-së Gjon Berisha dhe Urim Sallauka.

Trajnimi u mbajt më 27-28.11.2006 në zyrat e EBSCOS në Pragë. Qëllimi i trajnimit kishte të bënte me përgatitjet e stafit të BKUK-së, për përdorimin sa më të mirë të burimeve elektronike të blera nga kjo kompani. Qëllim tjetër i këtij trajnimi ishte që punëtorët e trajnuar në Pragë të jenë në gjendje të organizojnë trajnime për

përdorimin e revistave elektronike në Kosovë.

Risitë e këtij trajnimi ishin: puna në EBSCO Admin, konfigurimi dhe adaptimi i këtyre bazave, nxjerrja e raporteve mbi sasinë dhe mënyrat e përdorimit, përdorimi i një baze të re elektronike për mjekësi e ashtuquajtur DynaMed, etj.

Palët nga Praga dhe Kosova u pajtuan që faqja e EBSCO-s në internet të përkthehet në gjuhën shqipe, me qëllim të përdorimit sa më të lehtë të këtyre burimeve.



Në Maribor u mbajt Konferenca e COBISS-it 2006



(Maribor, 29-01 nëntor 2006)

Në Maribor të Sllovenisë, në Qendrën e Kongreseve Habakuk, nga 29.11.2006 deri më 01.2006, u mbajt Konferenca e COBISS-it (Sistemi i Bashkëpunimit dhe Shërbimeve Bibliografike në Internet) me temën: Gjendja e bibliotekarisë së Arsimit të Lartë në rajon. Në këtë konferencë morën pjesë mbi 400 pjesëmarrës të shteteve ballkanike, nga: Sllovenia, Kroacia, Mali Zi, Shqipëria, Kosova, Bosnja e Hercegovina, Maqedonia, Bullgaria, dhe Serbia, si dhe përfaqësues të Unionit Evropian dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në përbërje të delegacionit nga Biblioteka Kombëtare dhe Universitare të Kosovës, ishin: Izet Abdyl, sekretar, Besim Kokollarin, shef i QBU-ë dhe Ramush Zeka, shef i Departamentit të Teknologjisë Informative.

Gjatë Konferencës pati referime nga pjesëmarrës për gjendjen e bibliotekarisë së Arsimit të Lartë në rajon, për përvojat bibliotekare të shteteve përkatëse si dhe mundësitë e bashkëpunimit në kuadër të një rrjeti të përbashkët të automatizuar bibliotekar.

Gjatë Konferencës, delegacioni i BKUK-së kishte takime të veçanta edhe me drejtorin e IZUM-it z. Tomazh Seljak, si dhe me përfaqësues të bibliotekave nga Shqipëria, Maqedonia etj.

Mirënjohje për Zyrën Amerikane dhe z. Larry Corwin



(Prishtinë, 25 nëntor 2006)

Me rastin e 62-Vjetorit të themelimit të Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës dhe pëdurimit të Qendrës së Bibliotekës Universitare, drejtori i BKUK-së, dr. Sali Bashota e nderoi me mirënjohje të veçantë Zyrën Amerikane në Prishtinë, dhe Z. Larry Corwin, Zyrtar për Marrëdhënie me Publikun të kësaj Zyre, për kontributin e veçantë në mbështetjen dhe zhvillimin e BKUK-së dhe të Qendrës së posathemeluar të Bibliotekës Universitare.

PETRO MARKO (BIBLIOGRAFI), "NAIM FRASHËRI", TIRANË 2006

Petro Marko ka një biografi nga më të pasurat dhe më të bujshmet në letërsinë shqiptare. Puna dhe veprimtaria e tillë e Petro Markos e shpërndarë dhe e botuar nëpër botime të ndryshme monografike e serikë, është përmbledhur në mënyrë brilante në një bibliografi personale nga bibliografja me përvojë shumëvjeçare – Katerina Goshi.

Bibliografia në fjalë pasqyron krijimtarinë mbi 60-vjeçare të poetit, romancierit, novelistit, dramaturgut, shkrimtarit për fëmijë, gazetarit dhe përkthyesit të talentuar - Petro Marko.

Sipas hartueses së kësaj bibliografie, krijimtaria e Markos daton shumë herët, qysh në vitin 1930, kur shkrimtari, ende tepër i ri boton poezinë e tij të parë "Flamurit" në gazetën "Shqipëria e re" të Konstancës (Rumani).

Proza, poezia, shkrimet publicistike, por edhe mendimi kritik i Petro Markos për letërsinë dhe artin zënë një vend me rëndësi në bibliografinë në fjalë. Përveç krijimtarisë së tij, në këtë bibliografi përfshihen edhe shkrimet mbi krijimtarinë e shkrimtarit, si dhe ato mbi jetën e tij, të botuara në organet e shtypit.

Në aspektin e hartimit, bibliografia është ndarë në VIII rubrika sipas gjinive letrare, me nga dy ndarje - secila dhe një rubrikë (rubrika IX) për treguesit. E gjithë bibliografia ka renditje kronologjike, kurse brenda për brenda rubrikës janë renditur alfabetikisht. E rëndësishme është edhe se në disa raste bibliografia është pajisur me shënime mbi përmbajtjen e shkrimeve apo shkrimeve të tjera sipas gjykimit të bibliografes.

Bibliografia në fjalë përmban 1312 njësi bibliografike të shoqëruara me shënime plotësuese të radhitura në 388 faqe. Krejt në fund, ashtu siç e kërkojnë rregullat e bibliografike, bibliografia në fjalë është pajisur me një aparat të pasur informativ, si: treguesit alfabetik të shkrimeve të Petro Markos, të autorëve dhe titujve të poezive të përkthyer, të autorëve që kanë shkruar mbi të, të titujve të shkrimeve pa autorë mbi Petro Markon, të veprave të recensionuara, treguesit gjeografik dhe të personave për të cilët flitet në shkrimet e Petro Markos, të cilat e bëjnë bibliografinë shumë praktike dhe të lehtë për përdorim. Gjithnjë në shërbim të lexuesit, autorja e bibliografisë, për t'i lehtësuar lexuesit edhe konsultimin e shkrimeve të Petro Markos, në fund të çdo njësie bibliografike, ofron shënime mbi vendin e ndodhjes së asaj njësie me anë të numrit të sig-naturave.

FORMATI MARC: TË KUPTUARIT E NJËSIVE TË AUTORIZUARA (UNDERSTADING MARC AUTHORITY RECORDS), BIBLIOTEKA KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE E KOSOVËS, PRISHTINË 2006, 48 F.

Formati MARC: të kuptuarit e njësive të autorizuara, është një doracak i botuar më herët nga Biblioteka e Kongresit Amerikan dhe i përkthyer tash në gjuhën shqipe nga Besim Kokollari. E ndarë në XII pjesë të veçanta, ky doracak ofron shpjegime në lidhje me kuptimin se çfarë është një njësi në formatin MARC-Machine Readable Cataloging ("Me njësi në formatin MARC nënkuptojmë njësi kataloguese të lexueshme nga makina-kompjuteri"), si do të japë informacione themelore për të kuptuar dhe për të vlerësuar një njësi të automatizuar në formatin MARC. Ndërsa, pjesa tjetër "Të kuptuarit e formatit MARC për njësi bibliografike" shtjellon kuptimin e njësive bibliografike në formatin MARC.

Përkthimi i këtij doracaku është i mirëseardhur për punëtorët bibliotekarë, pikërisht në kohën kur sapo është filluar të punohet në BKUK me një program të automatizuar bibliotekar – ALEPH 500.

